

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

Programi: Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Biologji



TEZA MASTER

Ndikimi i fotografive, ilustrimeve dhe skicave në të nxënit e biologjisë së njeriut

Mentori:

Prof. Asoc. Zeqir Veselaj

Kandidate:

Gjyle Berisha

Prishtinë, 2022

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

Programi: Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Biologji



TEZA MASTER

Ndikimi i fotografive, ilustrimeve dhe skicave në të nxënit e biologjisë së njeriut

Mentori:

Prof. Asoc. Zeqir Veselaj

Kandidate:

Gjyle Berisha

Prishtinë, 2022

ABSTRAKT

Ky hulumtim ka të bëjë me ndikimin e fotografive, ilustrimeve dhe skicave në të nxënit e biologjisë së njeriut. Në lëndën e biologjisë nxënësit mësojnë një larmi procesesh jetësore të cilat ndodhin të organizmat e gjallë, shumë nga këto procese nuk mund t'i shohim se si ndodhin në të vërtetë, ato pra mund t'i shohim vetëm përmes fotografive, ilustrimeve apo skicave të bëra nga ana e mësimit me qëllim që të krijohet një përshkrim sa më i drejtpërdrejt tek nxënësit, të zhvillohet interesim dhe të sigurohet vëmendje.

Ky hulumtim është i rëndësishëm të studiohet, që në të ardhmen mësimit të zhvillojn një mësimit më efektive dhe nxënësit të ken mundesi që të marrin njohuri nga burime të ndryshme. Qëllimi i këtij hulumtimi është të zbulojë se sa i ndihmon nxënësve mësimit përmes fotografive, ilustrimeve, dhe skicave në të mësuarit dhe të mbajturit mend të njohurive në lëndën e biologjisë të klasës së VII-të.

Për realizimin e këtij hulumtimi është aplikuar metoda e hulumtimit në veprim. Si instrument matës në këtë hulumtim është përdorur pyetësi, mostër hulumtimi ishin nxënësit e dy e klasave të VII-ta të shkollës fillore të mesme të ulët "Ismet Rraci" në komunën e Klinës, pra mostra e zgjedhur është e qëllimshme, ku klasët janë përzgjedhur sipas kriterëve, si p.sh në bazë të notës mesatare në lëndën e biologjisë, njëra klasë ishte grup kontrollë ndersa tjetra grup eksperimental me gjithsej 46 nxënës.

Rezultatet që dolën nga analiza e të dhënave, vën në pah efektin pozitiv të përdorimit të fotografive, ilustrimeve dhe skicave gjatë mësimit, nga rezultatet e këtij hulumtimi vërejm se fotografitë, ilustrimet dhe skicat i ndihmojn nxënësit në arritjen e rezultateve të të nxënit në lëndën e biologjisë së klasës VII-të, kjo mund të vërehet nga rezultatet e nxënësve të grupit eksperimental apo grupit ku kemi përdorur fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimit, të cilët në fazën e pas testit treguan rezultate më të mira të të nxënit, në krahasim me fazën e para testit, poashtu është vërejtur edhe rritje e motivimit të nxënësve për zgjerimin e njohurive si dhe rritje e interesimit për lëndën e biologjisë.

Fjalët kyçe: *biologji, fotografi, ilustrime, mësimit, rezultate, skica.*

ABSTRACT

This research is about the impact of photographs, illustrations and sketches on human biology learning. In biology students learn a variety of life processes that occur in living organisms, many of these processes can not be seen how they actually occur, so we can only see them through photographs, illustrations or sketches of made by the teacher in order to create a description as direct as possible to the students, to develop interest and to provide attention.

This research is important to study, so that in the future teachers can develop a more effective teaching and students have the opportunity to receive knowledge from different sources. The purpose of this research is to find out how much teaching helps students through learning, illustrations, and sketches in learning and remembering knowledge in the subject of seventh grade biology.

For the realization of this research the method of action research has been applied. The questionnaire was used as a measuring instrument in this research, the research sample was the students of the two 7th grades of the lower secondary school "Ismet Rraci" in the municipality of Klina, so the selected sample is intentional, where the classes are selected according to criteria, such as based on the grade point average in biology, one class was a control group while the other was an experimental group with a total of 46 students.

The results of the data analysis highlight the positive effect of using photographs, illustrations and sketches in teaching. From the results of this research we see that photographs, illustrations and sketches help students in achieving learning outcomes in the subject. biology of grade VII, this can be seen from the results of the students of the experimental group or the group where we used pictures, illustrations and sketches during the teaching, who in the post-test phase showed better learning outcomes, compared to In the first phase of the test, there was also an increase in students' motivation to expand their knowledge and an increase in interest in biology.

Keywords: *biology, photography, illustrations, learning, results, sketches.*

DEDIKIM

Ky punim diplome i dedikohet babait tim i cili nuk gjendet më në mesin tonë, babë shpresoj që gjithmonë të ndihesh krenar me neve.

FALËNDERIM

Kam kënaqësin që për realizimin e këtij punimi të diplomës të nivelit master të falënderoj mentorin **Prof. Dr. Asoc. Zeqir Veselaj** për ndihmën dhe kontributin e dhënë, që të përfundoj me sukses këtë punim diplome, si dhe **Prof. Dr. Asoc. Ruzhdi Kuqi** dhe **Prof. Dr. Asoc. Teuta Danuza** për mbështetjen e ofruar gjatë punimit të kësaj teme diplome.

Poashtu falënderoj edhe institucionin në të cilin i kam mbledh të dhënat, shkollën fillore të mesme të ulët “Ismet Rraci” në Klinë, drejtuesit e kësaj shkolle nuk hezituan fare dhe me lejuan të mbledhja të dhënat pa ndonjë problem, falënderoj edhe nxënësit e të dy klaseve të shtata të cilët kanë marrë pjesë në këtë hulumtim përmes dhenies së përgjigjive të tyre, të cilat me ndihmuan në arritjen e rezultateve.

Falënderim i vaçant i takon familjes time të cilët më përkrahën që ta përfundoj me sukses këtë punim diplome, falënderoj edhe kolegët e miqt për sygjyerimet e tyre rreth këtij punimi.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	I
Kapitulli I HYRJE.....	2
Definimi i problemit, qëllimi i hulumtimit, pyetja dhe hipoteza e hulumtimit.....	3
Pyetja kryesore e hulumtimit dhe pyetjet ndihmëse	3
Kapitulli II SHQYRTIMI I LITERATURËS	5
Gjendja aktuale në sistemin arsimor në Kosovë.....	8
Arsimi në Kosovë gjatë pandemisë.....	10
Fotografitë.....	13
Ilustrimet	14
Skicat.....	17
Ndikimi i fotografive, ilustrimeve dhe skicave në procesin e mësimdhënies së biologjisë	19
Rritja e interesimit për lëndën.....	20
Zhvillimi i imagjinatës dhe kreativitetit.....	21
Lidhja ndërlëndore	22
Kapitulli III METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	24
Mostra e hulumtimit.....	24
Instrumenti për mbedhjen e të dhënave	25
Procedura	25
Kapitulli IV ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET.....	30
Kapitulli V DISKUTIMI DHE KONKLUDIMET.....	51
Diskutimi.....	51
Konkludimet	53
Kufizimet e studimit	55
Hulumtimet në të ardhmen.....	55

Implikimet praktike nga studimi	55
REFERENCAT BIBLOGRAFIKE	57
SHTOJCË: PYTËSORI	60

Lista e figurave

Figura 1. <i>Faqja 10 e librit të biologjisë së klasës së gjashtë, përmes fotografive janë paraqitur organizma të ndryshëm bimor dhe shtazor.</i>	13
Figura 2. <i>Faqja 49 e librit të biologjisë të klasës së shtatë, përmes ilustrimeve është paraqitur zemra e njeriut dhe ndertimi i brendshëm i saj.</i>	15
Figura 3. <i>Faqja 47 e librit të biologjisë së klasës së gjashtë, ku përmes skices janë paraqitur tri nivelet trofike.</i>	17
Figura 4. <i>Zhvillimi i njësis mësimore me klasën që është grup kontrollë</i>	25
Figura 5. <i>Zhvillimi i njësis mësimore me klasën që është grup kontrollë</i>	26
Figura 6. <i>Zhvillimi i njësis mësimore përmes projektorit me klasën që është grup eksperimental.</i>	27
Figura 7. <i>Shprendarja e fotografive të printuara për grupin eksperimental.</i>	28
Figura 8. <i>Shprendarja e pytësorëve në klasën që është grup eksperimenta (fotografia a) dhe klasën që është grup kontrollë (fotografia b).</i>	29

Lista e tabelave

Tabela nr.1. Karakteristikat përshkruese të mostrës pjesëmarrëse.....24

Tabela nr.2. Nxënësit pjesëmarrës në hulumtim.....30

Lista e grafikeve

Grafiku 1. Përgjigjiet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Si është e ndertuar zemra e njeriut? ” - faza e para testit.	31
Grafiku 2. Përgjigjiet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Si është e ndertuar zemra e njeriut? ” - faza e pas testit.	32
Grafiku 3. Përgjigjiet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Përshkruani funksionin e zemrës së njeriut ” - faza e para testit.	33
Grafiku 4. Përgjigjiet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Përshkruani funksionin e zemrës së njeriut ” - faza e pas testit.	34
Grafiku 5. Përgjigjiet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Përshkruani funksionin e enëve të gjakut” - faza e para testit.	35
Grafiku 6. Përgjigjiet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Përshkruani funksionin e enëve të gjakut” - faza pas testit.	36
Grafiku 7. Përgjigjiet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Çfarë nënkuptoni me qarkullim të dyfishtë të gjakut?” - faza e para testit.	37
Grafiku 8. Përgjigjiet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Çfarë nënkuptoni me qarkullim të dyfishtë të gjakut” - faza e pas testit.	38
Grafiku 9. Përgjigjiet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Çfarë mendoni si shkon gjaku në mushkri?” - faza e para testit.	39
Grafiku 10. Përgjigjiet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Çfarë mendoni si shkon gjaku në mushkri” - faza pas testit.	40
Grafiku 11. Përgjigjiet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Kur mësoni zakonisht a ju kushtoni më shumë vëmendje fotografive apo tekstit në libër?” - faza e para testit.	41
Grafiku 12. Përgjigjiet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Kur mësoni zakonisht a ju kushtoni më shumë vëmendje fotografive apo tekstit në libër?” - faza e pas testit.	42
Grafiku 13. Përgjigjiet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Cila mendoni se ju ndihmon më shumë gjatë mësimin, fotografitë apo përmbajtja e tekstit?” - faza e para testit.	43
Grafiku 14. Përgjigjiet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Cila mendoni se ju ndihmon më shumë gjatë mësimin, fotografitë apo përmbajtja e tekstit?” - faza e pas testit.	44

Grafiku 15. Përgjigjjet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Cilat njohuri i mbani mend më gjatë, ato që merrni përmes fotografive apo ato që mësoni nga përmbajtja e tekstit?” - faza e para testit.	45
Grafiku 16. Përgjigjjet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Cilat njohuri i mbani mend më gjatë, ato që merrni përmes fotografive apo ato që mësoni nga përmbajtja e tekstit?” - faza pas testit.	46
Grafiku 17. Përgjigjjet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “A përdorni ndonjëherë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimimit në orën e biologjisë?” - faza e para testit.	47
Grafiku 18. Përgjigjjet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “ A përdorni ndonjëherë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimimit në orën e biologjisë?” - faza e pas testit.	48
Grafiku 19. Përgjigjjet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “A do të deshironit të përdornit më shumë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimdhënies së biologjisë? - faza e para testit.	49
Grafiku 20. Përgjigjjet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “A do të deshironit të përdornit më shumë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimdhënies së biologjisë? - faza pas testit.	50

Kapitulli I HYRJE

Mësimdhënësit zakonisht përdorin pamje për t'i bërë konceptet të qarta dhe për të lehtësuar përqendrimin në elementet përkatëse. (Damiano, 2013) Përdorimi i imazheve në praktikën e mësimdhënies është një nevojë, një mundësi dhe një sfidë për mësimdhënësin modern (Rivoltella, 2012). Përmes situatave të njohura ose fotografive të subjekteve, është e mundur të kuptohet se çfarë është e panjohur, duke nxitur perceptimin stimulues. (Damasio, 2012)

Nëse përdoren fotografi në orën e biologjisë, kjo mund të stimulojë shqisat e nxënësve në klasë dhe do të lejojë ndërveprimin midis nxënësve dhe mësuesit. Këto mund ta bëjnë mësimin e biologjisë më tërheqëse dhe më interesant për nxënësit dhe gjithashtu do të përmirësoj motivimin dhe do të bëjë edhe mësimin më kuptimplotë dhe autentik, kjo është edhe arsyeja që me shtyri të kryej këtë studim, të shoh pra se si ndikojnë fotografitë, ilustrimet apo skicat në të mësuarit e biologjisë së njeriut, rëndësia kryesore e përdorimit të fotografive në mësimdhënien e biologjisë është se ndihmon në paraqitjen e dukurive dhe proceseve të ndryshme gjallërisht, simulojnë përmbajtje komplekse dhe paraqesin nivele të ndryshme të abstraksionit. Kështu, disa koncepte që dukeshin abstrakte për nxënësit mund të bëhen më të qarta dhe të kuptohen më mirë, kjo mund të ketë efekte pozitive në të ardhmen në arritjet akademike të nxënësve si dhe në qëndrimin e tyre ndaj mësimin të lëndës. (Sousa & Richter, 2017)

Potenciali i fotografisë, duhet që të jetë i lidhur ngushtë me riprodhimin e realitetit, me qartësinë dhe kuptimin. (Ritchin, 2012) Në bazë të një analize të bërë tekstit të biologjisë për klasën e shtatë të arsimit të mesëm të ulët, botim i vitit 2020, vërehet se fotografitë, ilustrimet, skicat dhe tabelat e shoqërojnë tekstin e çdo njësie mësimore duke ndihmuar dhe lehtësuar të mësuarit dhe të mbajturit mend të njohurive, fotografitë dhe ilustrimet janë të lidhura me tekstin e çdo njësie mësimore, ato e pasqyrojnë qartë çdo proces dhe ndërtimin e çdo pjese trupore, ato gjithashtu janë të një kualiteti shumë të lartë dhe kanë ngjyra që janë të përshtatshme për shqisën e të pamurit.

Ky punim diplome është i përbërë nga V kapituj, të kapitulli I përveq hyrjes, ofron dhe një zgjerim të koncepteve të përmbajtjes së këtij hulumtimi, definimin e problemit, qëllimin e hulumtimit, pyetjen dhe hipotezën e hulumtimit. Kapitulli II ofron një përmbledhje të hollësishme të literaturës, duke përfshirë pasqyra të studimeve dhe kërkimeve mbi konceptet e

çështjes që po hulumtohet pra rreth ndikimit të fotografive, ilustrimeve dhe skicave në të nxënit e biologjisë së njeriut dhe jep një pasqyrë të situatës aktuale të sistemit arsimor në Kosovë. Në Kapitullin III, përshkruhet metodologjia e hulumtimit duke përfshirë karakteristikat e mostrës, instrumentet, metodat e mbledhjes së të dhënave, dhe qasja ndaj analizës. Kapitulli IV paraqet në detaje gjetjet e studimit. Në fund, Kapitulli V diskuton gjetjet, nxjerrë konkludimet kyçe, shtjellon pikat e forta dhe kufizimet e studimit, udhëzimet e ardhshme për kërkime dhe implikimet përpraktikat e ardhshme.

Definimi i problemit, qëllimi i hulumtimit, pyetja dhe hipoteza e hulumtimit

Problemi i këtij hulumtimi është të zgjedh efektivitetin e të mësuarit të njohurive në prani dhe në mungesë të fotografive, ilustrimeve dhe skicave në lëndën e biologjisë, të nxënësit e klasave të VII-ta në shkollën fillore të mesme të ulët “Ismet Rraci” në Klinë. Pra përmes këtij hulumtimi do të zgjedhim problemin se a është me efektive të mësuarit e njohurive në lëndën e biologjisë në prani të fotografive, ilustrimeve dhe skicave apo në mungesë të tyre, ky problem është me rëndësi të zgjedhet sepse kështu ne do ta kuptojm se cila prej tyre është me efektive sepse sot vërejm mësimdhënësit e biologjisë se gjithnjë e më pak përdorin fotografi, ilustrime dhe skica poashtu zgjedhja e këtij problemi na jep mundësi të përdorim një qasje të re në mësimdhënien e biologjisë, me më pak teori dhe me më shumë fotografi, ilustrime dhe na ndihmon të kuptojmë rëndësin e përdorimit të fotografive, ilustrimeve dhe skicave në mësimdhënien e biologjisë.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të zbulojë se sa i ndihmon nxënësve mësimdhënien përmes fotografive, ilustrimeve, dhe skicave në të mësuarit dhe të mbajturit mend të njohurive në lëndën e biologjisë të klasës së VII-të. Hulumtimi ka për qëllim gjithashtu të vërej se si ndikon mësimdhënien përmes fotografive, ilustrimeve dhe skicave në arritjen e rezultateve më të mira të të nxënit të njohurive në biologjinë e njeriut, dhe sa ndikon në arritjen e rezultateve të të nxënit të biologjisë së njeriut.

Pyetja kryesore e hulumtimit dhe pyetjet ndihmëse

Pyetja kryesore e hulumtimit është si ndikon në arritjen e rezultateve të të nxënit të biologjisë së njeriut përdorimi i fotografive, ilustrimeve dhe skicave?

Ndërsa pyetjet ndihmëse të hulumtimit janë:

- Çfarë ndikimi ka prania apo mungesa e fotografive, ilustrimeve, dhe skicave në arritjen e rezultateve më të mira të të nxënit në biologjinë e njeriut?

- Sa e ndihmojnë fotografitë, ilustrimet dhe skicat arritjen e rezultateve të të nxënit në lëndën e biologjisë së klasës VII-të?

Hipoteza e hulumtimit

Hipoteza e këtij hulumtimi është: Përdorimi i fotografive, ilustrimeve dhe skicave ndikon pozitivisht në arritjen e rezultateve të të nxënit të biologjisë së njeriut.

Nënhipotezat e hulumtimit

Nënhipoteza e parë e këtij hulumtimi është: Prania apo mungesa e fotografive, ilustrimeve dhe skicave ndikon dukshëm në arritjen e rezultateve më të mira të të nxënit në biologjinë e njeriut.

Nënhipoteza e dytë është: Fotografitë, ilustrimet dhe skicat i ndihmojnë shumë nxënësit në arritjen e rezultateve më të larta të të nxënit në lëndën e biologjisë.

Kapitulli II SHQYRTIMI I LITERATURËS

Sipas një proverbi kinez, "*Një fotografi vlen një mijë fjalë*" (Bleed, 2006), tani paramendoni sa kohë i duhet nxënësve për të mësuar një mijë fjalë? Për shekuj me radhë, materialet e shkruara për mësim kanë përfshirë tekste dhe fotografi. Kombinimi i teksteve me fotografi zakonisht supozohet të ketë një efekt pozitiv në të mësuar. Kërkime të bollshme kanë demonstruar se nxënësit mësojnë përgjithësisht më mirë nga teksti dhe fotografitë sesa vetëm nga teksti, ilustrimet shpjeguese jo vetëm që përmirësojnë përmbajtjen, por edhe të kuptuarit e temës komplekse, e cila përfundimisht kthehet në aftësi më të mira për zgjidhjen e problemeve, me kusht që teksti dhe fotografitë të jenë koherente dhe të paraqiten hapësinore ose kohore afër njëra-tjetrës. (Mayer R. E., 2009) Përdorimi i imazheve fotografike është inkurajuar gjithnjë e më shumë nga arsimtarët për ta bërë procesin e të nxënimit të nxënësve më divergjent, si dhe të përmirësohen rezultatet e të nxënimit. (Sibanda, 2009)

Mësimi rreth ndarjes së qelizave fillon të na ndihmojë të kuptojmë se si secili prej nesh është bashkuar në imazhin e prindërve tanë, për të parë këtë ndarje të qelizave si dhe shumë procese të ngjajshme në biologjin e njeriut na ndihmojnë mjetet vizualizuese si video të ndryshme të zmadhuera në nivel mikroskopik, ose fotografitë ku demonstron hap pas hapi procesin. (Mcmillan, 2013)

Për një mësimdhënie efektive dhe të suksesshme të shkencës kërkohen mësues të kualifikuar të shkencave të cilët janë krijuar dhe të aftë të zbatojnë teknika, media dhe strategji të ndryshme të mësimdhënies, t'u shpjegojnë nxënësve koncepte abstrakte. Nëse mësuesit përdorin media vizuale krijuar për të dhënë mësim në fushën shkencës, shumica e nxënësve ka shumë të ngjarë të jenë në gjendje t'i zbatojnë këto koncepte në jetën e përditshme. (Barab, 2009), kështu edhe mësimet që nxënësit mësojnë nga biologjia e njeriut përmes fotografive apo mjeteve tjera vizuale kanë shumë të ngjarë të jenë në gjendje t'i zbatojnë ato koncepte në jetën e përditshme, sepse i mbajn mend me gjatë dhe i kuptojn më mire edhe proceset më të nderlikuara që nxënësit mësojnë në biologjin e njeriut. (A.Ireland, 2010)

Çështja e efektit të figurave në të mësuar është e ndërlikuar. Disa studime tregojnë se të mësuarit vetëm nga teksti ka qenë më i suksesshëm sesa të mësuarit nga teksti dhe fotografitë (Hannus, The role of pictures in learning biology, 2006), madje ai rekomandoi që librat shkollorë të kishin vetëm një sasi të vogël të figurave dhe kryesisht vizatimeve skematike, si dhe sugjeroi një largim

nga libri shkollor modern në formatin më tradicional që përfshin më shumë tekst. Ndërsa në disa studime të tjera është gjetur një efekt i përgjithshëm pozitiv i fotografive.(Reid D. , 2010a)

Studime më të hollësishme kanë treguar se fotografitë rrisin të kuptuarit nëse shpjegohen në tekst dhe se përmbajtja e fotove që nuk janë shpjeguar në tekst nuk është mësuar fare. (Reid D. , 2010b) Me sa duket fotografitë kanë një efekt të fortë pozitiv në kujtimin e gjërave, por jo domosdoshmërisht në kuptimin. Konceptet abstrakte mësohen më tepër nga teksti sesa nga fotografitë, fotografitë jo domosdoshmërisht promovojnë koncepte të të mësuarit. (Rasch, 2009). Por ndryshe qendron kjo qeshtje sipas autorit A. Ireland, sipas të cilit vizualizimi i përdorur gjatë shpjegimit të proceseve që nxënësit mësojnë në biologjinë e njeriut ndikon që nxënësit të kenë entuziazëm dhe të i kuptojn më mire proceset nga biologjia e njeriut. (A.Ireland, 2010)

Efekti i figurave në mësimdhënie varet gjithashtu nga aftësia njohëse e nxënësit, le të marrim një shembull mjaft të thjeshtë, një foto të një kafshe, një kërmilli, nxënësve të ndarë në grupe ju është shpjeguar e njëjta njësi mësimore por me dallim se njërit grup u janë paraqitur edhe fotografi, dhe pastaj u është kërkuar të rendisin detajet që ata kanë mësuar, numri i detajeve të renditura ndryshonte nga 5 në 15 mesatarisht, nga rezultatet e grupeve të nxënësve të shkollës fillore del se nga grupi ku është shpjeguar njësi mësimore pa fotografi, shumë raste as nuk i dinin emrat e saktë të pjesëve të kërmillit, për dallim nga grupi tjetër ku nxënësit nga skema e kërmillit përmendën disa tipare të rëndësishme diagnostikuese, prej të cilave më të rëndësishmet duket se janë tentakulat dhe guaska. Këto karakteristika së pari kontrollohen për të konfirmuar identifikimin. Pas kësaj skanohen karakteristikat e tjera. Kishte edhe nxënës të këtij grupi që edhe pse kishin par fotografit nuk i numëronin karakteristikat kryesore të kërmillit. Padyshim që fotografitë shqetësojnë përqendrimin në tekst të nxënësit me aftësi nën-mesatare. (Reid D. , 2010b). Një shpjegim i mundshëm gjendet në teorinë e ngarkesës njohëse: fotografitë nënkuptojnë një ngarkesë njohëse të huaj, që do të thotë një rënie në kapacitetin e punës së kujtesës (Cook, 2006). Kjo ndodh kur nxënësit duhet të kërkojnë vazhdimisht për segmente teksti ndërsa analizojnë (Florax, 2010). Gjithashtu stilet e të mësuarit (p.sh. nxënësit vizualë dhe verbalë) ndikojnë në mënyrën e përdorimit të fotografive në mësim. (Mayer R. E., 2003)

Ndërveprimi i fotos dhe tekstit është shumë i rëndësishëm në leximin e fotove të teksteve, burim për krijimin e kuptimit janë teksti i librit shkollor dhe fjalimi i mësuesit, megjithatë, këto nuk do

të garantojnë që nxënësit do të interpretojnë figurën në mënyrën e synuar. (Pozzer-Ardenghi, 2005).

Qëllimi i fotografive të librave shkollorë në shumicën e rasteve është i qartë. Ata ilustrjnë ose shpjegojnë pikat kryesore të njohurive faktike të dhëna në tekst të një kapitull. Në disa raste fotografitë nuk kanë asnjë qëllim dhe quhen thjesht dekorative, fotografitë menjëherë tërheqin vëmendjen e nxënësve dhe kjo është njëra prej funksioneve kryesore të tyre në librat shkollorë (Kearnsey, 2009), poashtu fotografitë përdoren si një mënyrë e përshtatëshme për të mbledhur informacion, eksploruar dhe për të mësuar nxënësit mbi biologjinë e njeriut, sepse ne si mësuesimdhënës për të shpjeguar qarkullimin e gjakut te bretkosa mundemi që të përdorim një bretkosë edhe të demonstrojm para nxënësve qarkullimin e gjakut, por nuk mundemi të veprojm njejt edhe me qarkullimin e gjakut të njeriu.

Kështu, fotografitë duket se e bëjnë subjektin ose temën më interesante. Funksionet e tyre në mësuesimdhënie janë zakonisht të ndara në afektive, p.sh. në rritje të motivimit, dhe njohëse, gjë që bën të kuptuarit e përmbajtjes më të lehtë. Fazë e veçantë është ajo e përdorimit të një figure në mësuesimdhënie, dhe planifikimi i diskutimit në klasë. Së pari, duhet të vendoset nëse do të fillojmë nga fusha njohëse ose afektive.

Për të zgjuar interes është mirë të fillohet nga reagimet e drejtpërdrejta afektive, sepse këto janë ato që vijnë në mendje së pari. Mësuesi mund ta përdorë këtë për të zgjuar interes, dhe këto ndjenja të evokuara ndihmojnë gjithashtu në kujtimin e gjërave (Pozzer, 2003). Sipas tyre funksionet e fotografive në librin e biologjisë janë të ndara në katër klasa: dekorative, ilustruese, shpjeguese dhe plotësuese. Funksionet aktuale të figurave në mësimin në klasë janë shumë të ndryshme, dhe mësuesit i ndryshojnë këto sipas kontekstit, objektivave të të mësuarit dhe grupit të synuar. Ka shumë pak përpjekje për të zhvilluar strategji të të nxënësve nga ilustrimet. Pothuajse pa përjashtim mësuesimdhënia drejtohet në mësimin e përmbajtjes së paracaktuar në një mënyrë të paracaktuar, dhe theksi është në përmbajtjen faktike.

Krahasuar me leximin e kuptimit të tekstit, njohuritë për të mësuar nga fotografitë janë shumë të kufizuara, prandaj aftësia e mësuesve për të përdorur fotografi në mësuesimdhënie është e dobët dhe leximi i figurave mësohet rrallë. Ekziston një mungesë e strategjive të të mësuarit për të kuptuarit e figurës (Schlag, 2011). Ndonjëherë për mësuesimdhënësit e biologjisë të shpjeguarit e fotografive të teksteve mësimore të biologjisë dinë të jetë sfiduese, sepse jo gjithmonë elementët strukturorë

të tekstit, mbishkrimet e fotografive dhe marrëdhëniet midis tyre janë të njejta, ato ndryshojnë ndërmjet librave shkollorë dhe herë pas here edhe brenda të njëjtit libër. Kjo natyrisht se do të ndikojë në interpretimet e lexuesve për fotografitë që ndryshojnë rolin e tyre në tekst.

Fotografitë janë një aspekt kryesor i librave shkollorë të shkencave, të cilat dominojnë qasjet në klasë të mësimdhënies dhe të të nxëniet. Prandaj është për t'u habitur që funksioni i fotografive dhe lidhja e tyre me nëntitujt dhe tekstet nuk përputhen, në këto raste rol të rëndësishëm në qartësimin e tyre dhe të kuptuarit e tyre nga ana e nxënësëve ka mësimdhënësi i biologjisë. Në një hulumtim të kryer u hetuandikimi, funksioni dhe struktura e fotografive në librat e biologjisë të shkollës fillore, qëllimi ishte të zbulohet se çfarë mund të mësojnë nxënësit nga librat shkollorë kur studiojnë fotografi? Për t'u përgjigjur kësaj dhe disa pyetjeve vartëse, ata zgjodhën dhe analizuan katër libra shkollorë brazilianë të biologjisë. Ata u përqendruan në përdorimin e fotografive dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre, lloje të ndryshme të teksteve dhe temën e paraqitur. Analiza e tyre zbulon se elementët strukturorë të tekstit, mbishkrimet dhe fotografitë dhe marrëdhëniet midis tyre ndryshojnë ndërmjet librave shkollorë dhe herë pas here edhe brenda të njëjtit libër. Kjo pastaj natyrisht se do të ndikojë në kuptuarit e tyre nga ana e lexuesve, për këtë të nxënësit mund të krijohet paqartësi për fotografitë që ndryshojnë rolin e tyre në tekst. Rezultatet e studimit kishin gjithashtu implikime për autorët e librave shkollorë dhe lexuesit e librave shkollorë.

Edhe ky hulumtim ngjajshëm sikurse hulumtimet më lartë të cilave ju referuam, do të hulumtoj përmes tekstit shkollor të biologjisë së klasës së shtatë, se si ndikojnë fotografitë, ilustrimet dhe skicat në të nxëniet e biologjisë së njeriut të nxënësit e klaseve të shtata, ku me theks të veçantë do të ndalemi të fotografitë, ilustrimet dhe skicat për njësin mësimore “Sistemi i qarkullimit të gjakut të njeriu”.

Gjendja aktuale në sistemin arsimor në Kosovë

Arsimi në Kosovë zhvillohet në institucione shtetërore dhe private. Duke filluar nga viti 1999, arsimi në Kosovë i u nënshtrua reformave në të gjitha nivelet: nga arsimi dhe edukimi parashkollor e deri në universitet. Këto reforma kishin për synim përshtatjen e arsimit në Kosovë sipas standardeve bashkëkohore evropiane e botërore. Si hap i pare i këtij sistemi të ri merret themelimi i Departamentit të Arsimit dhe Shkencës (DASH), që përcillet me krijimin e infrastructures ligjore dhe profesionale, e cila duhet të lehtësojë reformimin rrënjësor të arsimit

(sistemi 5 + 4 + 3 + 4 në arsimin e përgjithshëm dhe në atë profesional dhe Marrëveshja e Bolonjës në arsimin e lartë), si dhe me themelimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në mars të vitit 2002. Gjatë kësaj periudhe fillon të zhvillohet edhe sistemi privat i arsimit.

Institucionet shtetërore të arsimit në Kosovë qeverisen nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Sipas ligjit, arsimi fillor, i mesëm dhe së fundi edhe arsimi i lartë në Kosovë është falas dhe financohet nga buxheti i Kosovës. Arsimi është i detyrueshëm për të gjitha moshat nga 6 derinë 15 vjeç. Ligji për arsimin u garanton arsimim të barabartë të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Në vitin 2011 Kosova e ka miratuar Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (KKK), me qëllim të ngritjes së cilësisë së arsimit dhe harmonizimit të arsimit me vendet e zhvilluara. Nga kjo kornizë e re e planprogrameve u mundësua kalimi nga mësimdhënia e bazuar në objektiva e përmbajtje në mësimdhënien e bazuar në rezultate dhe zhvillim të zotësive praktike të nxënësve.

Spektori i arsimit vazhdon të mbetet një nga sferat më të kritikuar dhe më të ndjeshme shoqërore në Kosovë. Vështirësitë me të cilat përballlet arsimit në Kosovë janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga mungesa e infrastruktures së mjaftueshme shkollore, performanca e dobët e mësimdhënësve, mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për trajnimin e mësimdhënësve, materialet mësimore të papërshtatshme për planprogramin e ri dhe mungesa e mekanizmave për sigurimin e cilësisë. Për pasojë, sukcesi i çfarëdo përpjekjeje për përmirësimin e arsimit përmes intervenimeve në njërin nga këto nën-fusha ndërlihet ngushtë dhe varet nga përparimet në nën-fushat e tjera, pasi që të gjitha nënfushat ndërlihen mes vete.

Pastaj sa i përket pjesëmarrjes dhe gjithëpërfshirjes mund të themi se në këtë fushë sistemi arsimor është përballur me disa sfida që kanë të bëjnë me nivelin e ulët të përfshirjes në arsim të fëmijëve nga grupet e marginalizuara dhe fëmijëve me nevoja të veçanta. Por më emergjent ka qenë trajtimi i nivelit të ulët të përfshirjes së fëmijëve në edukimin e hershëm parashkollor. Përpos në nivelin parashkollor, Kosova ka arritur suksese të mira në gjithëpërfshirje në nivelet e tjera. Zgjidhja më e mire do të ishte ndërtimi i institucioneve parashkollore, gjë që do të rriste edhe shpenzimet kapitale por edhe do të krijonte qindra vende pune. Megjithatë, përshkak të kufizimeve buxhetore, është vendosur që të ngrihet niveli i pjesëmarrjes në arsimin parafillor, pasi që aty ka shpenzime më të vogla. Njëkohësisht do të stimulohet hapja e institucioneve

private dhe me bazë në komunitet. Përpyekjet për përmirësimin e sistemit arsimor gjatë dekadave të kaluara janë fokusuar në gjithëpërfshirje, ndërtimit të institucioneve dhe infrastructures përcjellëse shkollore dhe në rritje të pagave të mësimdhënësve. Kjo strategji ka arritur t'i përmirësojë pikat në të cilat ishte fokusuar, mirëpo nuk ka arritur sukses në përmirësimin e gjithmbarshëm të sistemit arsimor në Kosovë. Strategjia e Arsimit 2017-2021 përqendrohet në zbatimin e plan-programit të ri, tekstet shkollore dhe zbatimin e TIK-ut në arsim. Për të gjitha këto fusha janë analizuar alternative të shumta. Ideja e plan-programit të ri është që MASHT të përcaktojë zotësitë praktike që duhet arritur dhe të përpilojë planprogramet bërthamë, ndërsa shkollat përmbajtjet mësimore. Mirëpo përshkak të pamundësisë që përmbajtjet të krijohen nga shkollat, MASHT është i përfshirë në hartimin e përmbajtjeve mësimore dhe tekstet shkollore do të jenë në përputhje me ato përmbajtje. (Aliu, 2018)

Arsimi në Kosovë gjatë pandemisë

Marsin e vitit të kaluar, përderisa, një virus i ri u përshkallëzua në pandemi globale të njohur si COVID-19, qeveritë në pothuajse gjithë botën, morën vendimin e vështirë për mbylljen e dymëve të shkollave me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit dhe ruajtjes së shëndetit të qytetarëve. E gjendur në këto rrethana, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), pas mbylljes së shkollave më 12 mars 2020, në bashkëpunim me akterë të tjerë në sektorin e arsimit, përfshirë, drejtoritë komunale për arsim (DKA), organizatat joqeveritare (OJQ) dhe industrinë e teknologjisë informative (TI) ndërmoren hapat e shpejtë dhe të nevojshëm për organizimin e mësimin në distancë, e cila fillimisht u organizua përnxënësit në arsimin fillor (klasa 1-5), ndërkaq ditë më vonë edhe për nxënësit në arsimin e mesëm të ulët (klasa 6-9). Mësimi në distancë për këto nivele të arsimit përfshiu transmetimin e videoligjëratavenë Radio Televizionin Publik të Kosovës (RTK). Ndërkaq, për nivelin e mesëm të lartë, klasat 10 - 12 (gjimnazet dhe shkollat profesionale) organizimi i mësimin në distance ishte lënë në përgjegjësi të komunave. Në këtë drejtim, krahas videove të transmetuara, mësimdhënësit shfrytëzuan platform të ndryshme elektronike siç janë ZOOM, Skype, Google Meet, dhe Google Classroom, për të ndarë detyrat e shtëpisë dhe materialet e tjera mësimore. Gjatë po të njëjtës periudhë, MASHTI në bashkëpunim me donatorët si UNICEF dhe Save the Children lansoi dy platforma online, përkatësisht, platformën për edukimin në fëmijërinë e hershme për grupmoshat 0-6 vjeç 1 si dhe platformën për arsimin gjithëpërfshirës 2 .Krahas

këtyre, MASHTI zhvilloi edhe udhëzues të ndryshëm për realizimin e mësimit në distancë, i cili vazhdoi deri në përfundim të vitit shkollor 2019/20.

Ndërkaq, duke mos qenë një vit i zakonshëm, viti i ri shkollor 2020/21 në Kosovë filloi me vonesë në kushte të kufizimeve, me maska mbrojtëse, matje të temperaturës, dezinfektim duarsh dhe mjedisesh, si dhe distance fizike. Autoritetet arsimore në nivel qendror dhe local parashikuan organizimin e procesit mësimor sipas tre skenarëve: Skenari A – mësimi në shkollë; Skenari B – mësimi kombinuar dhe skenari C – mësimit në distancë, të përcaktuar në udhëzuesin e përgjithshëm të MASHTI për organizimin e vitit shkollor 2020/21 në kushtet dhe rrethanat e krijuara nga pandemia COVID-19. Përzgjedhja e skenarëve bëhet varësisht nga situata epidemiologjike në vend dhe kushtet specifike të institucioneve parashkollore/shkollave. Ndonëse nuk ka të dhëna të sakta, sipas MASHTI vlerësohet se shkollat në Kosovë kryesisht kanë funksionuar sipas skenarit A dhe B. Megjithëkëtë, kjo mënyrë e organizimit të mësimit në kushte pandemie, qoftë mësimit në shkollë, atij të kombinuar apo mësimit në distancë, u përball me sfida të shumta, si për mësuesit ashtu edhe për prindërit, nxënësit dhe komunitetin arsimor në përgjithësi. Kjo për arsye se përveç sfidave të tjerë, sistemi ynë arsimor nuk ishte i përgatitur për një mënyrë të tillë të mësimit dhe të nxënies. Masat e ndërmarra nga institucionet vendimmarrëse për organizimin e mësimit në distancë përmes transmetuesit publik RTK gjatë vitit të kaluar konsiderohen si të shpejta dhe në përputhje me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19 për të mundësuar vazhdimin e vitit shkollor dhe qasje në mësimit për të gjithë fëmijët/nxënësit e Kosovës. Megjithatë, e diskutueshme mbetet cilësia e organizimit të këtij mësimit në distancë, përfshirë cilësia e video-materialeve dhe cilësia e qasjeve të mësimit që i kanë praktikuar dhe që vazhdojnë t'i praktikojnë mësuesit gjatë mësimit në distancë. Në këtë drejtim, për kundër që ka kaluar mësuesit se një vit që nga fillimi i pandemisë dhe mobilizimit të të gjithë akterëve për organizimin e mësimit në distancë, vlen të theksohet se Kosovës ende i mungon një platformë e standardizuar për organizimin e mësimit në distancë. Si rrjedhojë, organizimi i procesit mësimor në kushte pandemie, vazhdon të mos jetë i unifikuar në nivel vendi, ku komunat/shkollat, përkatësisht mësuesit shfrytëzojnë platforme dhe qasje të ndryshme të mësimit dhe vlerësimit të nxënësve.

Në anën tjetër, me mbylljen e shkollave dhe më pastaj organizimin e mësimit në kushte pandemie, mësuesit në Kosovë janë përballur me sfidën e kalimit në mësimit në distancë,

e cila kërkon njohuri dhe shkathtësi të mira të shfrytëzimit të teknologjisë informative për mësimdhënie cilësore dhe efektive. Në këtë drejtim, ndonëse mungojnë të dhëna të sakta, një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve vlerësohet se nuk kishin përvojë të më hershme në organizimin e mësimi në distancë apo atij të kombinuar, ndërkaq, në anën tjetër, shfrytëzimi i teknologjisë gjatë procesit mësimor ishte tejte i ulët dhe përbente sfidë për sistemin arsimor në Kosovë edhe para shfaqjes së virusit COVID-19. Ngjashëm si më lartë, përkundër që ka kaluar më shumë se një vit që nga shfaqja e pandemisë, në Kosovë ka munguar ofrimi i mbështetjes për mësimdhënësit në zhvillimin e aftësive dixhitale, e cila i'u është lënë iniciativës dhe vullnetit të tyre. Në këtë drejtim, situata e krijuar nga COVID-19 dëshmoi edhe një here rëndësinë e integritit të TIK në mësimdhënie dhe nevojën për të investuar në infrastrukturën shkollore dhe zhvillimin e shkathtësive të mësimdhënësve në shfrytëzimin e TIK. Në të njëjtën linjë, u vë dukshëm në pah roli i prindërve në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve si dhe nevoja për të rritur përfshirjen e prindërve në jetën e shkollës, përmes funksionalizimit të këshillave të prindërve, dhe ofrimit të programeve trajnuese dhe aktiviteteve të tjera arsimore.

Nga sa u thamë sipër, pandemia dhe rrjedhimisht organizimi i mësimi në distancë, përveç sfidave, përbën një mundësi të mirë për të kuptuar rëndësinë dhe përparësinë e shfrytëzimit të teknologjisë në mësimdhënie dhe për të ndërmarrë masa konkrete në ndërtimin dhe përfshirjen e mësimi online në sistemin arsimor të Kosovës. Përkundër që kjo përbën sfidë, MASHTI dhe akterët e tjerë arsimor duhet të përfshihen në sigurimin e infrastructures së nevojshme dhe mbështetjen e vazhdueshme të shkollave në zhvillimin e kapaciteteve të tyre në shfrytëzimin e teknologjisë arsimore. Po ashtu, duke marrë parasysh se pandemia COVID-19 do të vazhdojë për një kohë të pacaktuar, është e domosdoshme që të zhvillohet një platform efektive, e standardizuar për organizimin e mësimi në distancë, e cila do të shfrytëzohej nga të gjitha shkollat dhe krahas kësaj të ngritën kapacitetet e mësimdhënësve në përdorimin e saj. (Rraci, 2021)

Për fund por jo më pak e rëndësishme, vlerësohet se e gjithë energjia gjatë përballjes me pandeminë është përqendruar në organizimin e procesit mësimor, pjesëmarrjen fizike në shkollë, realizimin e programeve mësimore, ndërkaq, shumë pak është ofruar këshillim dhe mbështetje emocionale për fëmijët gjatë kësaj periudhe. Duke pasur parasysh numrin e ulët të psikologëve dhe pedagogëve në shkolla në nivel vendi, Qeveria duhet të konsiderojë të investojë jo vetëm në

rritjen e numrit të psikologëve në shkolla, por edhe në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të tyre dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të tyre.

Fotografitë

Fotografitë në tekstet mësimore konsiderohen të vlefshme për të motivuar dhe zhvilluar krijimtarinë e nxënësve. Kur nxënësit lexojnë libra me figura pa shumë fjalë ata mësojnë të përdorin imagjinatën e tyre për të shpjeguar dhe rikrijuar dhe përfaqësuar pjesën e përmbajtjes që ata shikojnë në libra.




Figura 1. Faqja 10 e librit të biologjisë së klasës së gjashtë, përmes fotografive janë paraqitur organizma të ndryshëm bimor dhe shtazor.

Përdorimi i imazheve për qëllime edukative dhe mësimdhënie është thelbësor, dhe hartuesi i teksteve shkollore duhet të jetë i vetëdijshëm për dobinë e një imazhi. Në sistemin tradicional të arsimit, tekstet shkollore konsiderohen si një burim më i rëndësishëm në klasa, por vlerësuesi

nuk i kushton vëmendje ndikimit të fotografive në tekstet shkollore, ata vetëm përqendrohen në përmbajtje, tekstet shkollore duhet të korrespondojnë me nevojat e nxënësve dhe duhet të hartohet bazuar në metodologjinë e duhur, parimet psikologjike dhe gjuhësore duhet të marrin parasysh teknikat e pranuar të mësimdhënies.(Swanepoel, 2010)

Ndonjëherë fotografitë në tekstet shkollore janë dekorative dhe në shumicën e rasteve ilustruesit e teksteve shkollore nuk marrin parasysh filozofinë edukative dhe nevojat psikologjike të nxënësve në procesin e të mësuarit me fotografi dhe ilustrime. Kjo është veçanërisht e saktë sepse krijimi i shoqërisë krijuese ka nevojë për një sistem arsimor të vërtetë bazë, pra njerëzit kanë shumë potencial krijues për të arritur, dhe arsyeja kryesore është se krijimtaria e fëmijëve nuk ushqehet në mënyrën e duhur. Më pas roli jetësor i të menduarit, inovacionit dhe krijimtarisë nuk është zhvilluar plotësisht dhe shumë njerëz në disa vende ende nuk kujdesen ose vlerësojnë vlerën e krijimtarisë.(Edmunds, 2006)

Patjetër që ka shumë mënyra për të zbuluar potencialin krijues të nxënësit, duke përfshirë përmes arteve ekspresive, artit të lojës, lëvizjes, muzikës, vallëzimit, gjuhës dhe dramës, më parë, krijimtaria supozohej se luante një rol kryesor vetëm në fushën e artit dhe letërsisë; por studiuesit kanë ndryshuar supozimin e tyre dhe kanë kuptuar se krijimtaria është gjithashtu e rëndësishme në fusha të tjera. Aktivitetet krijuese nuk janë detyra të thjeshta. Për të bërë këto akte, individët kanë nevojë për këmbëngulje, këmbëngulje dhe aftësi për të përballuar sfidat që mbizotërojnë kur nxënësi përfshihet në detyrat dhe i shijon ato. Në lidhje me tekstet shkollore, është vërtetuar se karakteristikat e tekstit dhe fotografitë ndikuan në motivimin e nxënësve dhe mundësinë për kreativitet.(Daud, 2012)

Disa studiues kanë gjetur se librat shkollor me fotografi mund të motivojnë kreativitetin të nxënësit,për më tepër studimet vërtetuan se imazhet në materialin mësimor konsiderohen si faktorë tërheqës dhe gazmorë të leximit. (Kaufman, 2007) Ka shumë diskutime pra në lidhje me rolin dhe efikasitetin e përdorimit të pamjeve vizuale si një lehtësues i të mësuarit në sistemin arsimor.

Ilustrimet

Ilustrimi është një formë arti që përdoret kryesisht për të krijuar imazhe dhe fotografi për libra, sidoqoftë, përdorimi i ilustrimeve nuk është vetëm për të zbukuruar librat; ato janë të

rëndësishme në rritjen e përmbajtjes së shkruar të librit. Ilustrimet përdoren gjerësisht në librat për fëmijë për shkak të tërheqjes së tyre vizuale dhe për të ndihmuar fëmijën të kuptojë më mirë tekstin. Ilustrimet ndihmojnë lexuesin e hershëm të lidhë objektet dhe veprimet me fjalët. Kjo e ndihmon fëmijën të fillojë të kuptojë fjalët dhe të kalojë drejt bërjes së një lexuesi të rrjedhshëm. Ilustrimet mbajnë gjithashtu vëmendjen e një lexuesi të hershëm dhe e ndihmojnë fëmijën të lëvizë tregimin përpara pa ndihmën e të rriturve. Në fakt, në fazat e hershme të zhvillimit të fëmijëve, librat mund të përbëhen ekskluzivisht nga ilustrime, por ndërsa fëmijët bëhen më të aftë për të lexuar, ata kalojnë në libra me më shumë tekst dhe më pak imazhe.




Figura 2. Faqja 49 e librit të biologjisë të klasës së shtatë, përmes ilustrimeve është paraqitur zemra e njeriut dhe ndërtimi i brendshëm i saj.

Ilustrimet gjenden shpesh në libra për të rriturit sepse ilustrimet mund t'i ndihmojnë lexuesit të kuptojnë ide të cilat janë të vështira për t'u shpjeguar duke përdorur vetëm tekstin e shkruar.

Arsyeja për këtë është se truri i njeriut është në gjendje të perceptojë informacionin vizual më shpejt. Për më tepër, përfaqësimi vizual ka vlerë më të madhe të kujtesës dhe mbahet më gjatë në kujtesë sesa teksti i shkruar. Ilustrimet janë veçanërisht të dobishme në manualët mësimore, librat teknikë, libra të biologjisë dhe revistat mjekësore ku skicat teknike, diagramet e sakta dhe diagramet e rrjedhës përdoren për të përcjellë koncepte komplekse. Paraqitja e saktë vizuale është e nevojshme për përcjelljen e mesazheve që nuk mund të shprehen në mënyrë adekuate vetëm me fjalë. Librat shkollorë të shkencave përfshijnë dhe mbështeten shumë në këtë lloj informacioni vizual dhe shpjegues, ilustrimet pra luajnë një rol të rëndësishëm si në shkencë ashtu edhe në edukimin shkencor.(Gilbert, 2005)

Pse është e rëndësishme të kombinohen teksti me ilustrimet?, mund të jetë thjesht funksionale; ilustrimet dhe teksti kanë qëllime të ndryshme, përshtypje emocionale kundrejt analizës logjike për shembull. Një arsye tjetër mund të jetë që informacioni vizual konsiderohet si më shumë transparent për ilustrimin e proceseve komplekse. Një mundësi e tretë është që teksti dhe imazhet të ndjekin shtigjet paralele, pak a shumë duke paraqitur të njëjtin informacion, por ndoshta tërheqës për lexues të ndryshëm. Sidoqoftë, pak vëmendje është drejtuar saktësisht se cilat veçori bëjnë që teksti dhe imazhet të ndërveprojnë për të krijuar informacion kuptimplotë.(Martinec, 2005)

Kombinime të tekstit dhe ilustrimeve natyrisht përbëjnë sfida të një lloji për lexuesin. Edhe rastet më të thjeshta, fotografi që përfaqësojnë objekte në kombinim me një terminologji, kërkojnë aftësinë për të vëzhguar abstraksionet dhe për të bërë interpretime. Kur lëvizim në fushën shkencore, ilustrimet shpejt ngarkohen me informacion kompleks. Kuptimi i tyre madje mund të mos jetë i qartë për një mësues ose një autor tekstesh që tashmë e njeh mirë lëndën. Lexuesit megjithatë, duhet të dallojnë gjëra si proceset dhe lëvizjet nga imazhet që janë statike. Ata duhet të kuptojnë modele, dhe ato veçori nga ajo që është konkrete dhe natyraliste. Jo në mënyrë të pazakontë, modelet përfshihen në ilustrime të situatave konkrete, si elektronet e përfaqësuara me shenja minus brenda një llambë ose një teli, apo ndonjë proces biologjik siq është procesi i qarkullimit të gjakut, atë mund ta vërejnë përmes shigjetave të paraqitura në ilustrim, e thënë me thjesht ilustrimet pra përdoren për të përfaqësuar proceset dhe fenomenet komplekse.

Skicat

Për dallim nga fotografitë dhe ilustrimet që i hasim më shumë në librat e teksteve shkollore, skicat i hasim me pak, por ato me shpesh bëhen në drrasën e zezë nga ana e mësimeve. Skica e mësuesit në drrasën e zezë i lejon atij të paraqesë më me konsistencë, të qartë, më konkretisht dhe më të plotë materialin, dhe është më e lehtë për nxënësit të ndjekin mendimin e mësuesit, duke u përqëndruar në saktësisht detajet për të cilat flet dhe që riprodhohen në formën e një vizatimi. Me këtë teknikë vizualizimi, nxënësi përfshihet plotësisht në punë, sepse këtu aktivizohet memorja vizuale, dëgjimore dhe motorike. Paraqitja e skicave duhet të kryhet në mënyrë sinkronike në momentin kur mësuesi fillon t'i përdorë ato.




Figura 3. Faqja 47 e librit të biologjisë së klasës së gjashtë, ku përmes skices janë paraqitur tri nivelet trofike.

Me shumë rëndësi është mësimi sistematik i nxënësve për të shoqëruar përgjigjet me një skicë në tabelë. Kjo kontribuon në zhvillimin e koncepteve dhe përdoret gjerësisht në orët e biologjisë,

duke e bërë më të lehtë për të kuptuar çështje të vështira si psh spermatogjeneza, ovogjeneza, mitoza, mejoza, kryqezimet mono dhe dibrid, etj.

Në mësimdhënie skica përdoret për t'u treguar nxënësve një larmi objektesh dhe fenomenesh në një formë natyrale, është e mundur pra të njihen fëmijët me imazhet e njëjta të objekteve dhe fenomeneve. Të skicueara mund të jenë bimë, kafshë, fenomene dhe objekte të teknologjisë ose shkencës dhe shumë më tepër.

Si një nga mënyrat e skicimit, një dërrasë e zezë ose tabela e bardhë interactive përdoret gjerësisht. Ato shërbejnë si një zone për regjistrimin e fjalëve, fjalive, detyrave të ndryshme, ato mund të përshkruajnë rendin e veprimeve. Në rastin e përdorimit të skicave si një metodë mësimore vizive, është e nevojshme të vazhdohet sipas pikave të mëposhtme:

- Skicat duhet të jenë të përshtatshme për moshën e nxënësve, të aplikuara në moderim dhe vetëm në kohën e duhur për mësimin, të paraqiten në atë mënyrë që çdo nxënës të ketë qasje të plotë vizuale në skicën në fjalë;
- Mësuesi duhet të përmbushë detyrën për të identifikuar me saktë si më të rëndësishmet në procesin e shfaqjes së skicave, ai duhet të jetë i menduar mire për shpjegimet e elementeve kryesore dhe skicave në përgjithësi;
- Skica duhet të jetë në përputhje me përmbajtjen e materialit, një faktor i rëndësishëm është ana estetike e çështjes së performancës. Skica duhet të përfshijë vetë nxënësit në kërkimin dhe përcaktimin e informacionit të nevojshëm.

Skicimi ndihmon shumë në lëndën e biologjisë sepse kemi mjaft shumë procese komplekse të cilat mund të kuptohen me lehtë nese skicohen nga mësimdhënësi me këtë rast skicat edhe do të ndikojn në zhvillimin e një numri zonash të ndryshme të trurit. Zhvillon aftësinë për t'u përqëndruar dhe kushtuar vëmendje, një aftësi që mund të jetë shumë e dobishme gjatë gjithë jetës dhe karrierës. Ai gjithashtu zhvillon koordinimin sy-dorë në mënyrë që detyrat e përditshme të bëhen më të lehta për nxënësit.

Ndikimi i fotografive, ilustrimeve dhe skicave në procesin e mësimdhënies së biologjisë

Fotografitë, ilustrimet dhe skicat në tekstet mësimore ndikojnë në procesin mësimor. Materialet e përdorura nga mësuesit e sotëm janë të ndryshme, edhe menyra e shtjellimit të njësis mësimore është e ndryshme, apo si hierarki dhe fillon nga 1-6. Për shembull, nëse fjala është të shpjegojmë nxënësve informacione rreth një bretkoce, përdorimi i nivelit më të lartë në hierarki, niveli 6, do të duhej që klasa të udhëtonte në një lumë aty pranë dhe të shikonte vizualisht një bretkocë në vendlindjen e saj. Nëse ky nuk është një opsion i saktë, atëherë niveli i pestë, objekti, do të ishte të sillnim një bretkocë në klasë. Niveli i katërt i këtij sistemi, nxënësit do të shihnin modelin e një bretkoce. Në hapin e tretë, nxënësit do të shihnin ose krijonin fotografi të bretkocave. Gjatë nivelit të dytë, nxënësit do të lexonin përshkrimet e bretkocave, cilat janë karakteristikat e tyre etj. Së fundi, në nivelin e parë, nxënësit do të merrnin disa informacione verbale rreth bretkocave. Pra siq mund të shihet nga hierarkia menjeherë pas të gjallës vijën mjetet ndihmëse vizuale, siq janë edhe fotografitë në rastin tonë.

Në lidhje me funksionet e ndryshme didaktike të mjeteve vizuale, kërkohet përdorimi i tyre kompleks në mësim. Vetëm në këtë rast do të arrihet efikasiteti maksimal në zgjidhjen e secilës detyrë njohëse të mësimin. Në të njëjtën kohë, shumëllojshmëria e mjeteve të vizualizimit justifikohet vetëm në ato raste kur kërkohet të zbulohen aspekte të ndryshme të fenomenit ose objektit të studiuar, apo edhe kur është e nevojshme për nxënësit si p.sh., përfshirja sistematike të mjeteve vizuale në procesin mësimor, është shumë e rëndësishme për të siguruar zhvillimin e personalitetit të të verbërve dhe të dëmtuarve në shikim në procesin e të mësuarit, mjetet vizuale kontribuojnë në formimin e një botëkuptimi materialist të nxënësve të rinj të verbër dhe me shikim të dëmtuar (Sokolova, 2006). Ndihmat vizuale në kombinim të ngushtë me fjalën e mësuesit formojnë ide të sakta, të qarta të një nxënësi me dëmtime të shikimit, sqarojnë idetë ekzistuese, zhvillojnë vëmendjen dhe imagjinatën e tij. Poashtu mjetet vizuale si fotografitë mund të ndihmojnë shumë edhe nxënësit që i takojnë stilit vizuel të të mësuarit apo stilit pamor në kuptimin e proceseve të ndryshme biologjike.

Gjithashtu mjetet vizuale mund të ndihmojnë edhe nxënësit me disleksi dhe disgrafi, ata mundin që të përvetësojnë përmbajtjen mësimore me lehtë, psh një nxënës me disgrafi mundemi që gjatë vlerësimit të kërkojmë që përgjigjen për ndonjë proces të na skicojë në fletë, apo nxënësit me

disleksi përmes fotografive në tekst munden që të kuptojn njësin mësimore. Mjetet vizuale si fotografitë, ilustrimet, skicat apo edhe mejte të tjera janë pra të rëndësishme për një mësimdhënie me efektive për të gjithë nxënësit.

Rritja e interesimit për lëndën

Përdorimi i mjeteve vizuale ndihmëse mësimore, është një nga faktorët që ndihmon në përfshirjen e nxënësve në mësim sepse kur nxënësit shikojnë ndihmën ose modelin vizual, ai konsiderohet si një i përfshirë në procesin mësimor. Gjithashtu përdorimi i ndihmave vizuale inkurajon lëvizjen e trupit dhe mund të forcojë kontrollin, mjetet vizuale janë reciprokisht të dobishme për nxënësit dhe mësuesin, ndihmat vizuale pra rrisin interesin e nxënësve për lëndën.(Rautrao, 2012)

I njëjti autor deklaroi se shqisat vizuale kontribuojnë në të mësuarit të rreth 90 % të nxënësve ose në të mësuarit njerëzor. Kjo do të thotë që shqisat e tjera kanë vetëm 10 % kontribut në mësim. Ndhimat vizuale ju ndihmojnë dhe ju sigurojnë lehtësi për të arritur objektivat tuaja duke theksuar gjithçka që është duke u thënë ose shpjeguar në lidhje me një koncept ose fenomen të ri. Fotografitë e qarta rrisin nivelin e të kuptuarit të materialit të paraqitur dhe përdorimi i tyre do të lehtësojë mësimin, përforcojë thëniet, dhe do të sqarojë ide. Përdorimi më pak efektiv i mjeteve vizuale është kur nuk përdoret si një nga burimet e njohurive të reja, por shërben vetëm si një ilustrim i fjalës së mësuesit. Një nga detyrat e përmirësimit proces arsimor konsiston në përdorimin e gjerë të mjeteve vizuale në klasë si burime të pavarura informacioni. Kjo përfshin punën e pavarur të nxënësve me lloje të ndryshme të ndihmave individuale, material didaktike, mësimore lëndore dhe detyra të bazuara në studimin e ndihmave vizuale demonstruese.(V.Molochkov, 2006)

Studimet tregojnë se kur përdorni mjete vizuale, për efekt më të madh, objekti i shfaqur ose imazhi i tij duhet të komentohet, komentimi i objekteve të treguara që i lejon fëmijët të shohin në secilin objekt saktësisht atë që është kryesore dhe e zakonshme për të gjitha këto objekte dhe, kjo pastaj ndikon në rritjen e interesimit të tyre.

Sidoqoftë, në një numër studimesh theksohet se nuk duhet të zgjatemi për një kohë të gjatë në përdorimin e vizualizimit në mësimin e materialit tashmë të njohur, pasi kjo vonon kalimin e

nxënësit në krijimin e pavarur të një imazhi të objektit, në përgjithësimin dhe operacion me përmbajtje abstrakte, dhe rrjedhimisht vonon zhvillimin e të menduarit abstrakt tek fëmija.

Zhvillimi i imagjinatës dhe kreativitetit

Nxënësit shpesh shohin fotografitë, ilustrimet apo skicat para se të lexojnë tekstin dhe këto fotografi mund të rrisin fuqinë e imagjinatës së nxënësve poashtu fotografitë, ilustrimet apo skicat në tekstet shkollore mund të rrisin kreativitetin e nxënësve gjithashtu ato janë në gjendje të motivojnë nxënësit të studiojnë tekstin e bashkangjitur; ato mund të rrisin vëmendjen ose të inkurajojnë përpunimin më të detajuar të të dhënave tekstuale të përfshira në ilustrime, gjithashtu mund të shpjegojnë dhe bëjnë të qartë përmbajtjen që nuk është e lehtë për t'u kuptuar, ose mund të ndihmojnë në krijimin e kodeve joverbale përveç atyre verbale.

Dukshmëria është një nga komponentët e një sistemi të tërësishëm të të mësuarit që mund të ndihmojë një nxënës të përvetësojë më mire materialin që mësohet në një nivel më të lartë. Praktika e mësimdhënies tregon se me përfshirjen sistematike të mjeteve vizuale, pavarësia e nxënësëve rritet, aktiviteti i tyre rritet dhe formohet një qëndrim pozitiv ndaj lëndës. Kjo rrethanë është shumë e rëndësishme për të siguruar zhvillimin e personalitetit në procesin mësimor. (Korotkova, 2008)

Por ka edhe mendime që theksojnë se entuziazmi i tepërt për vizualizimin çon në frenimin e zhvillimit të të menduarit abstrakt, pa të cilin njohja efektive e realitetit përreth është e pamundur. Përdorimi i bollshëm i vizualizimit shpesh shpërndan vëmendjen e nxënësve, tërheq vëmendjen nga njohuritë e ideve kryesore të temës, veçanërisht kur bëhet fjalë për nxënësit jo me kujtesë vizuale-figurative, por me kujtesë verbale-logjike. Efektiviteti i përdorimit të mjeteve vizuale në procesin arsimor varet jo vetëm nga kombinimi i justifikuar pedagogjikisht i llojeve të tij të ndryshme në mësim, por edhe nga raporti i saktë i vizualizimit dhe burimeve të tjera të njohurive, në veçanti fjalët e mësuesit. Shkencëtari i famshëm - psikologu L.S. Vygotsky dalloj dy nivele të zhvillimit të aftësive të fëmijës: niveli i zhvillimit aktual (niveli i zhvillimit të arritur tashmë) dhe zona e zhvillimit proksimal (ajo që është në procesin e formimit, "e nesërmja" e zhvillimit). Bazuar në këtë dispozitë, mund të themi se niveli i zhvillimit aktual të një fëmije të klasës së parë është aktivitetet mendore efektive vizuale i bazuar në perceptimin e operacioneve praktike të kryera me

objekte, dhe aktivitet mendorvizual-figurativ, pastaj verbal-logjik është zona e zhvillimit proksimal. Kjo është arsyeja pse, kur mësoni fëmijët në klasat fillore, dhe veçanërisht në klasën I, nevojitet një sekuencë e qartë në përdorimin e mjeteve mësimore: nga veprimet me objekte volumetrike e specifike në një kalim gradual në veprime me material didaktik (fotografitë e objekteve) dhe, së fundi, për objekte më abstrakte (figura gjeometrike, modele ikonike, etj.).

Duke marrë parasysh rezultatet e hulumtimit të psikologëve që mbizotëron vëmendja e pavullnetshme tek nxënësit e shkollave fillore, se puna monotone shumë shpejt e lodh fëmijën dhe nevojën për të ndryshuar llojet e veprimtarisë, ky aktivitet me fotografi shpesh mund të krijoj gjallëri.

Lidhja ndërlëndore

Pasi që hulumtimi ka të bëjë me fotografi, ilustrime dhe skica, të gjitha këto janë art, dhe menyra se si i kuptojn ato nxënësit ndërlidhet me procese psikologjike si përceptimi dhe të menduarit. Nga prania e fotografive, ilustrimeve dhe skicave në klasë pra sigurohet ndërlidhja lëndore e procesit të mësimdhënies me artin, shkencën si dhe psikologjin.

Lidhur me këtë ndërlidhje ka pasur gjithmon diskutime për atë se çfarë është në të vërtetë mësimdhënia art apo shkencë?. Nese është art mësimdhënia kërkon frymëzim, intuitë, talent e krijimtari dhe pak prej tyre mund të mësohen. Nese është shkencë, mësimdhënia kërkon njohuri dhe shprehje që me të vërtetë mund të mësohen.

Po t'i referohemi argumentit të dytë, se mësimdhënia është shkencë, atëherë mësimdhënia kërkon zgjedhjen dhe zbatimin e formulave të sakta për çdo situatë në klasë. Rregullat dhe veprimet efektive të mësuesve të ndryshëm mund të mësohen dhe të zbatohen në klasë.

Po t'i referohemi argumentit tjetër se mësimdhënia është art, atëherë as që mund të bëhet fjalë për zotërimin e shprehive të mësimdhënies përmes të nxënit.

Ka mësimdhënës dhe punonjës të arsimit që bazohen vetëm në argumentin e parë ose të dytë, duke besuar se mësimdhënia është tërësisht art ose vetëm shkencë dhe azgjë më shumë. Një pjesë tjetër pranojnë që mësimdhënia i ka së bashku elementet artistike dhe shkencore.

Pohimi se mësimdhënia ka një bazë shkencore do të thotë se studiuesit e edukimit kanë akumuluar në mënyrë të kujdesshme një trung njohurish që kanë të bëjnë me raportet e përhershme dhe jo të rastësishme midis mësimdhënies dhe të nxënit.(B.Musai, 1999)

Si përfundim mund të themi se mësimdhënia e mirë ka mbrenda elemente të punës së artistit dhe të studiuesit. Suksesi i saj varet nga njohja e psikologjisë së artistit dhe shkencëtarit.

Kapitulli III METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Për realizimin e këtij hulumtimi do të aplikojmë metoden e hulumtimit në veprim. Siç nënkuptohet edhe prej vetë emrit, hulumtimi veprues përbëhet prej dy komponentëve: hulumtim dhe veprim. Hulumtimi është mjet për veprim, ose për ta përmirësuar punën tuaj praktike ose për të ndërmarrë veprim për t'u ballafaquar me një problem apo çështje. Të dhënat mblidhen përmes procesit të hulumtimit, i cili në rastin tonë është cilësor, ndërsa ndryshimet bëhen përmes veprimit. Si mënyrë hulumtimi në këtë hulumtim pra do të përdoret veprimi. Do të intervenojmë pra përmes fotografive, ilustrimeve dhe skicave dhe do të vërejmë se si do të ndikojnë ato në të nxënësit e njohurive të biologjisë. Hulumtimi do të realizohet me nxënësit e dy klasave të VII-ta në shkollën fillore të mesme të ulët “Ismet Rraci” në komunën e Klinës, ku njëra klasë do të jetë grup eksperimental dhe tjetra grup kontrollë, të cilat do të shpjegojmë njësinë e njëjtë mësimore, “Sistemi i qarkullimit të gjakut”, por me një dallim se të grupi eksperimental do të përdorim fotografi, ilustrime dhe skica, ndërsa të grupi kontrollë do të përdorim formën klasike të mësimdhënies, më pas të dy grupet do të ju nënshtrohen instrumenteve për mbledhjen e të dhënave.

Mostra e hulumtimit

Si mostër hulumtimi janë nxënësit e klasave të VII-ta të shkollës fillore të mesme të ulët “Ismet Rraci” në komunën e Klinës, prej tyre në hulumtim kanë marr pjesë 2 klasë të shtata, ku njëra është grup kontrolli, ndërsa tjetra grup eksperimental. Mostra që përdoret në këtë hulumtim është mostër kuotë, pra mostra e zgjedhur është e qëllimshme, ku klasat janë përzgjedhur sipas kriterëve, si p.sh në bazë të notës mesatare në lëndën e biologjisë, numri total i nxënësve në këto klasa është 46.

Tabela nr.1. Karakteristikat përshkruese të mostrës pjesëmarrëse

Komuna	Klinë
SHFMU	“Ismet Rraci”
Klasa	VII ₁ dhe VII ₂
Numri i nxënësve pjesëmarrës	46

Instrumenti për mbedhjen e të dhënave

Të dhënat do të mbedhen përmes pytësorit. Pytësori është një listë e shkruar e pyetjeve, përgjigjet e së cilës shënohen nga vetë pjesëmarrësit. Së këndejmi, pjesëmarrësit i lexojnë pyetjet, i interpretojnë sipas tyre dhe pastaj i shkruajnë përgjigjet. Llojet e pyetjeve që do të përdorim janë pyetjet e hapura ku, kategoritë e mundshme të përgjigjeve nuk jepen në pytësor, gjithësej pytësori do të përmbajë 10 pyetje të hapura, pyetjet do të jenë rreth njësisë mësimore “Sistemi i qarkullimit të gjakut” dhe si qëllim është të mbledhim të dhëna rreth njohurive të nxënësve para dhe pas shpjegimit të njësisë mësimore, për të zbuluar se si kanë ndikuar në të nxënit e njohurive fotografitë, ilustrimet dhe skicat, pytësori do të jetë anonim, në mënyrë që nxënësit të mos hezitojnë në dhënien e përgjigjeve.

Procedura

Pasi kam përfunduar pytësorin kam filluar menjëherë me procedurën e mbledhjes së të dhënave, të cilën e realizova në shkollën fillore të mesme të ulët “Ismet Rraci” në klinë, me dy klasë të shtata të kësaj shkolle, klasën VII₁ dhe VII₂, ku e para ishte si grup kontroll ndersda e dyta si grup eksperimental.



Figura 4. Zhvillimi i njësis mësimore me klasën që është grup kontrollë

Fillimisht për të dy klasët në takimin e parë kam bërë shprehdarjen e pyetësorëve në menyrë të njëjtë, por procedura ndryshon në takimin e dytë, tani në klasën VII₁ që është grup kontroll e zhvillojm njësin mësimore “Sistemi i qarkullimit të gjakut” në mënyrë tradicionale, pa burime shtesë, pa fotografi, ilustrime dhe skica, vetëm me ndihmen e librit.



Figura 5. Zhvillimi i njësis mësimore me klasën që është grup kontrollë



Figura 6. Zhvillimi i njësis mësimore përmes projektorit me klasën që është grup eksperimental.

Ndërsa në klasën VII2 që është grup eksperimental, njësin mësimore e zhvillova me ndihmën e projektorit ku janë shfaqur, fotografi, ilustrime dhe skica, të cilat poashtu i kam printuar dhe ju kam shpërndarë nxënësve gjatë procesit mësimor.



Figura 7. Shpërndarja e fotografive të printuara për grupin eksperimental.

Fotografitë, ilustrimet dhe skicat e njësive mësimore që e zhvillova me ndihmën e projektorit të grupit eksperimental i kam printuar dhe ju kam shpërndarë nxënësve gjatë procesit mësimor.



a)



b)

Figura 8. Shprendarja e pyëtësorëve në klasën që është grup eksperimenta (fotografia a) dhe klasën që është grup kontrollë (fotografia b).

Pas realizimit të njësis mësimore në të dyja klasët vazhdova me shprendarjen e pyëtësoreve për fazën e pas testit.

Kapitulli IV ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET


Në hulumtim kanë marrë pjesë nxënësit e dy klasëve të shtata të shkollës fillore të mesme të ulët “Ismet Rraci” në komunën e Klinës, klasët e përfshira në hulumtim janë VII₁ dhe VII₂.

Tabela nr.2. Nxënësit pjesëmarrës në hulumtim.

Shkolla	Klasa VII ₁	Klasa VII ₂	Gjithësej
“Ismet Rraci”	23	23	46


Nga tabela mund të shihet se në hulumtim kanë marrë pjesë pra 46 nxënës të klasëve VII₁ dhe VII₂, si instrument për mbledhjen e të dhënave cilësore është përdorur pytësori me 10 pyetje të hapura, i njëjti pytësor është përdorur në të dyja fazat e hulumtimit, si para testit ashtu edhe pas testit, me qëllim që të zbulohet ndikimi i fotografive, ilustrimeve dhe skicave në të nxënit e njohurive të biologjisë se njeriut. Në vazhdim kemi rezultatet e hulumtimit të pytësorit të nxënësve, rezultatet do të paraqiten duke i krahasuar përgjigjet e nxënësve të dy klasëve në fazën e para testit me atë të pas testit.

1. Si është e ndertuar zemra e njeriut?



Grafiku 1. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “Si është e ndertuar zemra e njeriut?” - faza e para testit.


Në grafikun nr.1 shihet se kemi 21% të nxënësve të grupit kontrollë me përgjigjie të saktë në pyetjen “Si është e ndertuar zemra e njeriut?” në fazën e parë të testit, ndersa 18 nxënës apo 79% janë përgjigjiur pasaktë, te grupi eksperimental për të njëjtën pyetje në fazën e parë të testit, kemi 17% të nxënësve me përgjigjie të saktë dhe 83% të tyre me përgjigjie të pasaktë.



Grafiku 2. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “Si është e ndertuar zemra e njeriut?” - faza e pas testit.


Sipas rezultateve nga grafiku 2, mund të shihet se 11 nxënës apo 47% të nxënësve të klasës VII₁ apo grupi kontrollë kanë përgjigje të saktë në pyetjen “Si është e ndertuar zemra e njeriut?” në fazën e pas testit dhe 12 nxënës apo 53% kanë përgjigje të pasaktë, ndërsa nga klasa VII₂ apo grupi eksperimental për pyetjen e njëjtë në fazën e njëjtë poashtu kanë 18 nxënës apo 79% përgjigje të saktë dhe 5 nxënës apo 21% e tyre kanë përgjigje të pasaktë. Nëse bëjmë një krahasim të përgjigjeve të nxënësve në mes të fazës së parë dhe të dytë vërejmë se në fazën e pas testit kemi rritje të përgjigjeve të sakta sidomos të grupi eksperimental ku njësia mësimore është shpjeguar me fotografi, ilustrime dhe skica.

2. Përshkruani funksionin e zemrës së njeriut?



Grafiku 3. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “Përshkruani funksionin e zemrës së njeriut ” - faza e para testit.


Në pyetjen “Përshkruani funksionin e zemrës së njeriut?” në fazën e para testit nga rezultatet e grafikut nr.3, vërejm se 26% të nxënësve të grupit kontrollë kanë përgjigje të saktë dhe 74% e tyre kanë përgjigje të pasaktë, ndërsa te grupi eksperimental kemi 34% përgjigje të saktë dhe 66% e tyre kanë përgjigje të pasaktë për pyetjen e njejtë në fazën e njejtë poashtu.



Grafiku 4. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “Përshkruani funksionin e zembrës së njeriut ” - faza e pas testit.


Përseri për pyetjen “Përshkruani funksionin e zembrës së njeriut?” tani në fazën e pas testit nga grafiku 4, mund të shihet se 56% të nxënësve të grupit kontrollë kanë përgjigje të saktë dhe 44% kanë përgjigje të pasaktë, ndërsa në grupin eksperimental për pyetjen e njejtë në fazën e njejtë poashtu kemi 82% të nxënësve me përgjigje të saktë dhe 18% e tyre kanë përgjigje të pasaktë. Nese bëjm një krahasim të përgjigjeve të nxënësve në mes të fazës së parë dhe të dytë vërejm se në fazën e pas testit kemi rritje të përgjigjeve të sakta sidomos kjo rritje vërehet të grupi eksperimental apo klasa VII₂.

3. Përshkruani funksionin e enëve të gjakut?



Grafiku 5. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “Përshkruani funksionin e enëve të gjakut” - faza e para testit.


Nga përgjigjet e nxënësve sipas grafikut nr.5, mund të shihet se vetëm një numër i vogël i nxënësve kanë informacione për funksionin e enëve të gjakut, pra vetëm 13% të nxënësve të grupit kontrollë kanë përgjigje të saktë në pyetjen “Përshkruani funksionin e e enëve të gjakut?” në fazën e para testit dhe 20 nxënës apo 87% kanë përgjigje të pasaktë, ndërsa nga grupi eksperimental për pyetjen e njëjtë në fazën e njëjtë poashtu kemi numër më të madh të përgjigjeve të sakta, pra kemi 26% të nxënësve me përgjigje të saktë dhe 74% e tyre me përgjigje të pasaktë.



Grafiku 6. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “Përshkruani funksionin e enëve të gjakut” - faza pas testit.


Tani në fazën e pas testit situata si mund të shihet në grafik ka ndryshuar, sepse tani kemi 61% të nxënësve të klasës VII₁ apo të grupit kontrollë me përgjigje të saktë në pyetjen “Përshkruani funksionin e enëve të gjakut?” dhe 39% me përgjigje të pasaktë, ndërsa te grupi eksperimental për pyetjen e njejtë në fazën e njejtë poashtu kemi 78% të nxënësve me përgjigje të saktë dhe 22% e tyre kanë përgjigje të pasaktë. Nese bëjm një krahasim pra të përgjigjieve të nxënësve në mes të fazës së parë dhe të dytë vërejm se në fazën e pas testit kemi rritje të përgjigjieve të sakta sidomos të grupi eksperimental ku njësia mësimore është shpjeguar me fotografi, ilustrime dhe skica.

4. Çfarë nënkuptoni me qarkullim të dyfisht të gjakut?



Grafiku 7. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “Çfarë nënkuptoni me qarkullim të dyfisht të gjakut?” - faza e para testit.


Siç vërehet nga grafiku nr.7, edhe për pyetjen “Çfarë nënkuptoni me qarkullim të dyfisht të gjakut?” nxënësit nuk kanë shumë njohuri në fazën e para testit, ku kemi vetëm 17% të nxënësve të klasës VII₁ apo grupi kontrollë me përgjigje të saktë dhe 19 nxënës apo 83% me përgjigje të pasaktë, ndërsa nga klasa VII₂ apo grupi eksperimental për pyetjen e njejtë në fazën e njejtë poashtu kemi vetëm 1 nxënës me përgjigje të saktë dhe 22 nxënës apo 96% e tyre kanë përgjigje të pasaktë, pra një numer edhe më i madh i përgjigjeve të pasakta se te grupi kontrollë.



Grafiku 8. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “Çfarë nënkuptoni me qarkullim të dyfishtë të gjakut” - faza e pas testit.


Pas përdorimit të fotografive, ilustrimeve dhe skicave në fazën e pas testit nxënësit siç shihet nga rezultatet e grafikut nr.8, kanë arritur të kuptojn më mire qarkullimin e dyfishtë të gjakut, mund të shihet pra se 43% të nxënësve të klasës VII₁ apo të grupit kontrollë tani kanë përgjigje të saktë në pyetjen “Çfarë nënkuptoni me qarkullim të dyfishtë të gjakut” dhe 13 nxënës apo 57% kanë përgjigje të pasaktë, ndërsa nga klasa VII₂ apo grupi eksperimental për pyetjen e njejtë në fazën e njejtë poashtu kanë 14 nxënës apo 60% përgjigje të saktë dhe 9 nxënës apo 40% e tyre kanë përgjigje të pasaktë.

5. Çfarë mendoni si shkon gjaku në mushkri?



Grafiku 9. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “Çfarë mendoni si shkon gjaku në mushkri?” - faza e para testit.


Nga rezultatet e grafikut nr.9, mund të vërehet se vetëm një numer i vogël i nxënësve dinë se si shkon gjaku në mushkri, në fazën e para testit kemi pra vetëm 8% të nxënësve të grupit kontroll me përgjigje të saktë në pyetjen “Çfarë mendoni si shkon gjaku në mushkri?” dhe 98% kanë përgjigje të pasaktë, edhe nga klasa VII₂ apo grupi eksperimental për pyetjen e njejtë në fazën e njejtë poashtu kemi përseri vetëm 8% të nxënësve me përgjigje të saktë dhe 21 nxënës apo 98% e tyre kanë përgjigje të pasaktë sikurse të grupi kontrollë.



Grafiku 10. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “Çfarë mendoni si shkon gjaku në mushkri” - faza pas testit.


Nga grafiku nr.10, në fazën e pas testit kemi më shumë nxënës të cilët e dinë tani se si shkon gjaku në mushkri pra nga grafiku mund të shihet se 30% të nxënësve të klasës VII₁ apo të grupit kontrollë kanë përgjigje të saktë në pyetjen “Çfarë mendoni si shkon gjaku në mushkri?” dhe 70% të tyre i kemi me përgjigje të pasaktë, ndërsa te grupi eksperimental për pyetjen e njejtë kemi numër edhe më të madh të përgjigjeve të sakta, kemi pra 52% të nxënësve me përgjigje të sakta dhe 48% me përgjigje të pasakta.

6. Kur mësoni zakonisht a ju kushtoni më shumë vëmendje fotografive apo tekstit në libër?



Grafiku 11. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “Kur mësoni zakonisht a ju kushtoni më shumë vëmendje fotografive apo tekstit në libër?” - faza e para testit.


Sipas grafikut 11, mund të shihet se në pyetjen “Kur mësoni zakonisht a ju kushtoni më shumë vëmendje fotografive apo tekstit në libër?” në fazën e para testit kemi 13 nxënës apo 56% të nxënësve të klasës VII₁ apo grupi kontrollë të cilet janë përgjigjur se i kushtojn më shumë vëmendje tekstit dhe 10 nxënës apo 44% janë përgjigjur se ju kushtojn më shumë vëmendje fotografive, edhe nga klasa VII₂ apo grupi eksperimental për pyetjen e njejtë në fazën e njejtë poashtu kemi 12 nxënës apo 52% që i kushtojn më shumë vëmendje tekstit dhe 11 nxënës apo 48% e tyre janë përgjigjur se ju kushtojn më shumë vëmendje fotografive, pra kemi përafersisht përqindje të njejtë të nxënësve që ju kushtojn rendesi tekstit dhe fotografive në të dy grupet.



Grafiku 12. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “Kur mësoni zakonisht a ju kushtoni më shumë vëmendje fotografive apo tekstit në liber?” - faza e pas testit.


Nga përdorimi i fotografive, ilustrimeve dhe skicave siç duket kemi ndryshim të mendimeve të nxënësve në grupin eksperimental, kjo mund të vërehet nga rezultatet e grafikut 12, ky ndryshim nuk mund të themi se vlen edhe për grupin kontrollë sepse mund të shihet se prap 56% të nxënësve janë përgjigjur se i kushtojn më shumë vëmendje tekstit në pyetjen “Kur mësoni zakonisht a ju kushtoni më shumë vëmendje fotografive apo tekstit në liber?” dhe 44% janë përgjigjiur se ju kushtojn më shumë vëmendje fotografive, ndersa nga klasa e grupit eksperimental për pyetjen e njejtë siç tham kemi ndryshim të mendimit të nxënësve sepse tani kemi 3 nxënës apo 14% janë përgjigjur që i kushtojn më shumë vëmendje tekstit dhe 20 nxënës apo 86% e tyre janë përgjigjur se ju kushtojn më shumë vëmendje fotografive.

7. Cila mendoni se ju ndihmon më shumë gjatë mësimit, fotografitë apo përmbajtja e tekstit?



Grafiku 13. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Cila mendoni se ju ndihmon më shumë gjatë mësimit, fotografitë apo përmbajtja e tekstit?” - faza e para testit.


Sipas rezultateve të grafikut 13, mund të shihet se 56% të nxënësve në grupin kontrollë janë përgjigjur se ju ndihmon më shumë teksti në pyetjen “Cila mendoni se ju ndihmon më shumë gjatë mësimit, fotografitë apo përmbajtja e tekstit?” në fazën e para testit dhe 10 nxënës apo 44% janë përgjigjur se ju ndihmojnë më shumë fotografitë, te grupi eksperimental për pyetjen e njëjtë kemi 48% të nxënësve që ju ndihmon më shumë teksti dhe 52% e tyre janë përgjigjur se ju ndihmojnë më shumë fotografitë.



Grafiku 14. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII1 dhe VII2 në pyetjen “Cila mendoni se ju ndihmon më shumë gjatë mësimit, fotografitë apo përmbajtja e tekstit?” - faza e pas testit.


Edhe në fazën e pas testit kemi prap 56% të nxënësve të klasës VII1 apo të grupit kontrollë që janë përgjigjur se ju ndihmon më shumë teksti në pyetjen “Cila mendoni se ju ndihmon më shumë gjatë mësimit, fotografitë apo përmbajtja e tekstit?” dhe 44% që janë përgjigjiur se ju ndihmojn më shumë fotografitë, ndersa nga klasa VII2 apo grupi eksperimental për pyetjen e njejtë 8% janë përgjigjur që ju ndihmon më shumë teksti dhe 20 nxënës apo 86% e tyre janë përgjigjur se ju ndihmojn më shumë fotografitë, pra këtu shihet ndikimi që kanë pasur fotografitë, ilustrimet dhe skicat gjatë shpjegimit të njësis mësimore.

8. Cilat njohuri i mbani mend më gjatë, ato që merrni përmes fotografive apo ato që mësoni nga përmbajtja e tekstit?



Grafiku 15. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “Cilat njohuri i mbani mend më gjatë, ato që merrni përmes fotografive apo ato që mësoni nga përmbajtja e tekstit?” - faza e para testit.


Në pyetjen “Cilat njohuri i mbani mend më gjatë, ato që merrni përmes fotografive apo ato që mësoni nga përmbajtja e tekstit?” në fazën e para testit në grafikun 15 mund të shihet se 9 nxënës apo 39% të nxënësve të grupit kontrollë janë përgjigjur se i mbajn mend më shumë njohuritë e mësuera nga teksti dhe 14 nxënës apo 61% janë përgjigjur se mbajn mend më shumë njohuritë e mësuera nga fotografitë, situat pak me ndryshe qendron te klasa VII₂ apo grupi eksperimental ku për të njejtën pyetjen kemi 10 nxënës apo 43% që mbajn mend më shumë njohuritë e mësuera nga teksti dhe 13 nxënës apo 57% e tyre janë përgjigjur se mbajn mend më shumë njohuritë e mësuera nga fotografitë.



Grafiku 16. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “Cilat njohuri i mbani mend më gjatë, ato që merrni përmes fotografive apo ato që mësoni nga përmbajtja e tekstit?” - faza pas testit.


Nga ajo që shihet në grafikun 16, mund të kuptohet se nuk ka ndryshuar diçka në mendimin e nxënësve të grupit kontrollë as në fazën e pas testit sa i përket pyetjes “Cilat njohuri i mbani mend më gjatë, ato që merrni përmes fotografive apo ato që mësoni nga përmbajtja e tekstit?” sepse prap kemi 9 nxënës apo 39% të nxënësve që janë përgjigjur se i mbajn mend më shumë njohuritë e mësuera nga teksti dhe poashtu 14 nxënës apo 61% janë përgjigjiur se mbajn mend më shumë njohuritë e mësuera nga fotografitë, ndersa nga klasa VII₂ apo grupi eksperimental për pyetjen e njejtë në fazën e njejtë poashtu tani pas përdorimit të fotografive siç duket nxënësit kanë ndryshuar mendim sepse kemi 7 nxënës apo 31% që janë përgjigjur se mbajn mend më shumë njohuritë e mësuera nga teksti dhe 16 nxënës apo 69% e tyre që janë përgjigjur se mbajn mend më shumë njohuritë e mësuera nga fotografitë.

9. A përdorni ndonjëherë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimit në orën e biologjisë?



Grafiku 17. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “A përdorni ndonjëherë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimit në orën e biologjisë?” - faza e para testit.


Nga rezultatet e përgjigjive të nxënësve për pyetjen “A përdorni ndonjëherë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimit në orën e biologjisë?” në fazën e para testit mund të shihet se konkretizimi i njësive mësimore përmes vizualizimit nuk qendron edhe keq, nga 23 nxënës të grupit kontrollë, 12 nxënës apo 52% janë përgjigjur se përdorin fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimit në orën e biologjisë dhe 11 nxënës apo 48% janë përgjigjur se nuk i përdorin ato, ndersa nga klasa VII₂ apo grupi eksperimental për pyetjen e njëjtë në fazën e njëjtë poashtu janë 10 nxënës apo 44% që janë përgjigjur se përdorin fotografi gjatë mësimit në orën e biologjisë, dhe 13 nxënës apo 56% e tyre janë përgjigjur se nuk përdorin fotografi gjatë mësimit në orën e biologjisë.



Grafiku 18. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “ A përdorni ndonjëherë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimit në orën e biologjisë?” - faza e pas testit.


Edhe në fazën e pas testit siç shihet nga rezultatet e grafikut 18 kemi prap 12 nxënës apo 52% të nxënësve të klasës VII₁ apo grupi kontrollë janë përgjigjur se përdorin fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimit në orën e biologjisë në pyetjen “A përdorni ndonjëherë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimit në orën e biologjisë?” dhe 11 nxënës apo 48% poashtu janë përgjigjur se nuk i përdorin ato, ndersa nga klasa VII₂ apo grupi eksperimental për pyetjen e njejtë në fazën e njejtë tani janë 15 nxënës apo 65% që janë përgjigjur se përdorin fotografi gjatë mësimit në orën e biologjisë, dhe 8 nxënës apo 35% e tyre janë përgjigjur se nuk përdorin fotografi gjatë mësimit në orën e biologjisë, pra te grupi eksperimental ku kemi përdorur fotografi, ilustrime dhe skica nxënësit janë përgjigjur që i përdorin më shpesh ato gjatë mësimit në orën e biologjisë.

10. A do të deshironit të përdornit më shumë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimdhënies së biologjisë?



Grafiku 19. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “A do të deshironit të përdornit më shumë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimdhënies së biologjisë?” - faza e para testit.

Si duket nga rezultatet e grafikut 19, nxënësve ju pelqen më shumë mësimdhënia përmes vizualizimit, ku nga 23 nxënës kemi 14 nxënës apo 60% të nxënësve të grupit kontrollë që janë përgjigjur se do të deshironin të përdorin fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimdhënies së biologjisë në pyetjen “A do të deshironit të përdornit më shumë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimdhënies së biologjisë?” në fazën e para testit dhe 9 nxënës apo 40% janë përgjigjur se nuk deshirojnë të i përdorin ato, edhe të grupi eksperimental për pyetjen e njëjtë në fazën e njëjtë poashtu janë 13 nxënës apo 56% që janë përgjigjur se do të deshironin të përdorin fotografi gjatë mësimdhënies së biologjisë, dhe 10 nxënës apo 56% e tyre janë përgjigjur se nuk do të deshironin të përdorin fotografi gjatë mësimdhënies së biologjisë.



Grafiku 20. Përgjigjet e nxënësve të klasëve VII₁ dhe VII₂ në pyetjen “A do të deshironit të përdornit më shumë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimdhënies së biologjisë? - faza pas testit.

Në klasën ku nuk kemi përdorur fotografi, ilustrime dhe skica mund të shihet se përsëri në fazën e pas testit kemi 14 nxënës apo 60% të nxënësve që janë përgjigjur se do të deshironin të përdorin fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimdhënies së biologjisë në pyetjen “A do të deshironit të përdornit më shumë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimdhënies së biologjisë?” dhe 9 nxënës apo 40% janë përgjigjiur se nuk deshirojnë të i përdorin ato, ndërsa nga grupi eksperimental siç shihet nga grafiku nr.20 për pyetjen e njejtë tani janë 22 nxënës apo 95% që janë përgjigjiur se do të deshironin të përdorin fotografi gjatë mësimdhënies së biologjisë, dhe 1 nxënës apo 5% e tyre janë përgjigjiur se nuk do të deshironin të përdorin fotografi gjatë mësimdhënies së biologjisë, pra siç shihet nga këto rezultate të grupit eksperimental ku kemi përdorur fotografi, ilustrime skica, nxënësve tani ju pelqen më shumë mësimdhënia përmes vizualizimit dhe do të deshironin të praktikonin më shumë këtë formë.

Kapitulli V DISKUTIMI DHE KONKLUDIMET

Diskutimi

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të zbulojë se sa i ndihmon nxënësve mësimdhënia përmes fotografive, ilustrimeve, dhe skicave në të mësuarit dhe të mbajturit mend të njohurive në lëndën e biologjisë të klasës së VII-të. Hulumtimi kishte për qëllim gjithashtu të vërej se si ndikon mësimdhënia përmes fotografive, ilustrimeve dhe skicave në arritjen e rezultateve më të mira të nxënësve të njohurive në biologjinë e njeriut të nxënësve të klaseve të shtata. Nga rezultatet e këtij hulumtimi kemi vërejtur efektin pozitiv të fotografive, ilustrimeve dhe skicave në të nxënësve të lëndës së biologjisë dhe motivimin e tyre për mësimin e lëndës. Nga të dhënat e mbledhura nga pyetësi me nxënës, kemi arritur të marrim përgjigje për pyetjen kryesore hulumtuese:

Sa ndikon përdorimi i fotografive, ilustrimeve dhe skicave në arritjen e rezultateve të nxënësve të biologjisë së njeriut?

Nga rezultatet e këtij hulumtimi vërejm se përdorimi i fotografive, ilustrimeve dhe skicave ndikon në arritjen e rezultateve të nxënësve të lëndës së biologjisë së klasës VII-të, kjo mund të vërehet nga rezultatet e nxënësve të grupit eksperimental apo grupit ku kemi përdorur fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimdhënies, të cilët në fazën e pas testit treguan rezultate më të mira të nxënësve të lëndës së biologjisë, në krahasim me fazën e para testit apo para përdorimit të fotografive, ilustrimeve dhe skicave. Poashtu kemi arritur të marrim përgjigje edhe për pyetjet ndihmëse:

Çfarë ndikimi ka prania apo mungesa e fotografive, ilustrimeve, dhe skicave në arritjen e rezultateve më të mira të nxënësve të biologjinë e njeriut?

Sa e ndihmojnë fotografitë, ilustrimet dhe skicat arritjen e rezultateve të nxënësve të lëndës së biologjisë së klasës VII-të?

Rezultatet e nxënësve të grupit eksperimental apo grupit ku në prani të fotografive, ilustrimeve dhe skicave është realizuar mësimdhënia, ishin më të mira në krahasim me rezultatet e grupit kontrollë ku kishte mungesë të fotografive, ilustrimeve dhe skicave gjatë mësimdhënies, në arritjen e këtyre rezultateve ndikim kishte prania apo mungesa e fotografive, ilustrimeve, dhe skicave gjatë mësimdhënies. Po nga këto rezultate arritëm të vërtetojmë hipotezën e parashtruar:

Përdorimi i fotografive, ilustrimeve dhe skicave ndikon në arritjen e rezultateve të nxënësve biologjisë së njeriut.

Kërkime të bollshme kanë demonstruar se nxënësit mësojnë përgjithësisht më mirë nga teksti dhe fotografitë sesa vetëm nga teksti, ilustrimet shpjeguese jo vetëm që përmirësojnë përmbajtjen, por edhe të kuptuarit e temës komplekse, e cila përfundimisht kthehet në aftësi më të mira për zgjidhjen e problemeve, me kusht që teksti dhe fotografitë të jenë koherente dhe të paraqiten hapësinore ose kohore afër njëra-tjetrës (Mayer R. E., 2009), kështu edhe mësimet që nxënësit mësojnë nga biologjia e njeriut përmes fotografive apo mjeteve tjera vizuale kanë shumë të ngjarë të jenë në gjendje t'i zbatojnë ato koncepte në jetën e përditshme, sepse i mbajnë mend me gjatë dhe i kuptojnë më mirë edhe proceset më të ndërlikuara që nxënësit mësojnë në biologjinë e njeriut. (A.Ireland, 2010)

Poashtu ngjajshëm me rezultatet që kemi arritur ne, është rekomanduar nga Sibanda që të arrihen rezultate më të mira të nxënësve, ku sipas tij përdorimi i imazheve fotografike është inkurajuar gjithnjë e më shumë nga arsimtarët për ta bërë procesin e nxënësve më divergjent, si dhe të përmirësohen rezultatet e nxënësve. (Sibanda, 2009)

Se rritet motivimi dhe interesimi i nxënësve për lëndën tregon edhe hulumtimi në vazhdim, ku sipas tij kur përdorim mjete vizuale si ndihmë mësimore, është një nga faktorët që ndihmon në përfshirjen e nxënësve në mësim sepse kur nxënësit shikojnë ndihmën ose modelin vizual, ai konsiderohet si një i përfshirë në procesin mësimor. Gjithashtu përdorimi i ndihmave vizuale inkurajon lëvizjen e trupit dhe mund të forcojë kontrollin, mjetet vizuale janë reciprokisht të dobishme për nxënësit dhe mësuesin, ndihmat vizuale pra rrisin interesin e nxënësve për lëndën. (Rautrao, 2012)

Përveq interesimit që rritet të nxënësve nga rezultatet është vërejtur se edhe zhvillohet imagjinata dhe kreativiteti, kjo mbështet edhe Korotkova sipas tij nxënësit shpesh shohin fotografitë, ilustrimet apo skicat para se të lexojnë tekstin dhe këto fotografi mund të rrisin fuqinë e imagjinatës së nxënësve poashtu fotografitë, ilustrimet apo skicat në tekstet shkollore mund të rrisin kreativitetin e nxënësve gjithashtu ato janë në gjendje të motivojnë nxënësit të studiojnë tekstin e bashkangjitur; ato mund të rrisin vëmendjen ose të inkurajojnë përpunimin më të detajuar të dhënave tekstuale të përfshira në ilustrime, gjithashtu mund të shpjegojnë dhe bëjnë të qartë përmbajtjen që nuk është e lehtë për t'u kuptuar, dukshmëria është një nga komponentët e

një sistemi të tërësishëm të të mësuarit që mund të ndihmojë një nxënës të përvetësojë më mire materialin që mësohet në një nivel më të lartë. Praktika e mësimdhënies tregon se me përfshirjen sistematike të mjeteve vizuale, pavarësia e nxënësve rritet, aktiviteti i tyre rritet dhe formohet një qëndrim pozitiv ndaj lëndës. Kjo rrethanë është shumë e rëndësishme për të siguruar zhvillimin e personalitetit në procesin mësimor. (Korotkova, 2008)

Konkludimet

- Në këtë punim hulumtues përmes analizës së pyetësorit të 46 nxënësve pjesëmarrës në hulumtim kam pasur si qëllim të hulumtojë ndikimin e fotografive, ilustrimeve dhe skicave në të nxënësit lëndës së biologjisë tek nxënësit e klasëve të shtata.
- Rezultatet nga hulumtimi i bërë kanë treguar ndikim pozitiv nga prania e fotografive, ilustrimeve dhe skicave në arritjen e rezultateve më të larta të të nxënësit në lëndën e biologjisë.
- Ndikimi pozitiv është vërejtur të klasa që ishte si grup eksperimental ku janë përdorur fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimdhënies, në krahasim me grupin kontrollë ku mësimdhënia pa fotografi, ilustrime dhe skica nuk ka ndikuar në arritjen e rezultateve më të larta në të nxënësit e biologjisë, kjo vërehet nga rezultatet e para testit dhe të pas testit tek të dy klasët, kështu për pyetjen e parë “Si është e ndertuar zemra e njeriut” të dy klasat kanë rritje të përqindjes të përgjigjies së saktë në fazën e para testit, por rritje më e lartë e përqindjes vërehet të grupi eksperimental, i cili në fazën e para testit kishte vetëm 4 nxënës apo 17% me përgjigjie të saktë, ndërsa në fazën e pastestit kemi 18 nxënës apo 79% me përgjigjie të saktë, e njëjta vërehet edhe me pyetjet “Përshkruani funksionin e zemrës së njeriut” dhe “Përshkruani funksionin e enëve të gjakut”, edhe për këto pyetje vërehet pra se kemi rritje të dukshme të përqindjeve të përgjigjieve të sakta për grupin eksperimental në krahasim me grupin kontrollë.
- Prania e fotografive, ilustrimeve dhe skicave gjatë mësimdhënies ka pasur ndikim edhe në zhvillimin e imagjinatës dhe kreativitetit të nxënësit, kjo vërehet sidomos të përgjigjet e nxënësve për pyetjet “Çfarë nënkuptoni me qarkullim të dyfishtë të gjakut”, dhe “Çfarë mendoni si shkon gjaku në mushkri”, nga përgjigjet e nxënësve të grupit eksperimental kam vërejtur se kanë pasur zhvillim më të lartë të imaxhinatës dhe të kreativitetit në

përgjigjet e tyre në fazën e pas testit, këtu poashtu mund të vërehet se kemi edhe diferencën më të madhe në mes të grupit kontrollë dhe eksperimental, në pyetjen “Çfarë nënkuptoni me qarkullim të dyfishtë të gjakut”, në fazën e para testit 83% e nxënësve të grupit kontrollë kishin përgjigje të pasaktë dhe të grupi eksperimental 96% e tyre kishin përgjigje të pasaktë, në fazën e pas testit te grupi kontrollë 57% e tyre vazhdojn të kenë përgjigje të pasaktë ndersa te grupi eksperimental janë 40% e tyre me përgjigje të pasaktë, përsëri për pyetjen “Çfarë mendoni si shkon gjaku në mushkri” 98% e nxënësve tek të dyja grupet kishin përgjigje të pasaktë në fazën e para testit, në fazën e pas testit të grupi kontrollë kemi 70% të nxënësve përsëri me përgjigje të pasaktë, ndersa grupi eksperimental ka 48% të nxënësve me përgjigje të pasaktë.

- Është vërejtur edhe rritje e motivimit të nxënësve për zgjerimin e njohurive si dhe rritje e interesimit për lëndën e biologjisë, këtë e tregojn edhe nxënësit me përgjigjet e tyre në pyetje “ Kur mësoni zakonisht a ju kushtoni më shumë vëmendje fotografive apo tekstit në libër”, tek të dy grupet është vërejtur se ju kushtojn më shumë vëmendje fotografive, pra fotografitë në tekst e rritin vëmendjen edhe interesimin e tyre për lëndën, kjo është vërejtur sidomos të grupi eksperimental ku kemi përdorur fotografi, ilustrime dhe skica, ku 86% prej tyre në fazën e pas testit janë përgjigjur se ju kushtojn më shumë vëmendje fotografive.
- Rezultatet nga hulumtimi i bërë treguan se nxënësit e të dy klasëve preferonin më shumë që mësimdhënia e biologjisë të zhvilloht përmes fotografive, ilustrimeve dhe skicave, kjo kuptohet edhe nga rezultatet sepse në pyetjen “A do të deshironit të përdornit më shumë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimdhënies së biologjisë, nxënësit e të dyja klasëve janë përgjigjur se do të deshironin të përdornin më shumë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimdhënies së biologjisë, poashtu në pyetjet “ Cila mendoni se ju ndihmon më shumë gjatë mësimin, fotografitë apo përmbajtja e tekstit ” si dhe “ Cilat njohuri i mbani mend mend më gjatë, ato që merrni përmes fotografive apo ato që mësoni nga përmbajtja e tekstit” nxënësit e të dyja klasëve janë mendojn se gjatë mësimin më shumë ju ndihmojn fotografitë, dhe i mbajn mend më shumë ato njohuri që kanë përfituar nga fotografitë se nga përmbajtja e tekstit.

Kufizimet e studimit

Në këtë studim janë paraqitur këto kufizime: Meqë duhej të mblidhen dy bashkësi të të dhënave, ku bëhen dy kontakte me popullatën e studimit, studimi është edhe më ishtrenjtë edhe më i vështirë për t'u realizuar. Poashtu kërkoi kohë më të gjatë për ta kryer, pasi duhet të prisnim derisa të kryhet intervenimi para se të nisni mbledhjen e bashkësisë së dytë me të dhëna. Kalimi i kohës mes dy kontakteve rezultojë në pakësim të populates së studimit, pasi që disa prej pjesëmarrësve nga faza e para testit munguan në fazën e pas testit. Edhe një kufizim tjetër është përdorimi i një instrumenti të njejtë të hulumtimit dy here siq është pytësori për të matur qëndrimin e populates karshi një çështjeje, kjo ka sjellur deri të ndryshimi i qëndrimit të tyre mes dy pikave kohore të mbledhjes së të dhënave.

Hulumtimet në të ardhmen

Hulumtime të ngjajshme mund të zhvillohen në të ardhmen, si psh., mund të studiohet ndikimi i mjeteve audio-vizuele në të mësuarit biologjisë së qelizës, si moster e hulumtimit do ishin nxënësit e klaseve të dhjeta të shkollës së mesme të lartë, ku do të hulumtohej se si ndikon paraqitja me video e procesit të ndarjes me mitozë dhe me mejozë të qelizave në të nxënit e njohurive nga ana e nxënësve në biologjinë e qelizës. Metoda e hulumtimit do të ishte hulumtimi në veprim, ku së pari përmes instrumentit për mbledhjen e të dhënave siq janë pytësoret do të merrnim informacione se sa dinë nxënësit për temën në fjalë, më pas do të intervenonim me video dhe pastaj përmes pytësorit dhe të dhënave të marra do të kuptonim se si kan ndikuar mjetet audio-vizuele në të mësuarit e biologjisë së qelizës.

Implikimet praktike nga studimi

Rezultatet e këtij studimi mund të na ndihmojn në praktikën e mësimdhënies, në atë se si mund të zhvillohet një mësimdhënie më efektive nga ana e mësimdhënësve për nxënësit, sepse gjithnjë synohet që të kalojm nga mësimdhënia klasike në atë moderne të shekullit XXI, sigurisht që në mësimdhënien moderne fjala e mësimdhënësit nuk është i vetmi burim i njohurive, sepse nxënësit kanë mundësi që të marrin njohuri nga burime të ndryshme, dhe siq u pa edhe gjatë këtij

studimi, nxënësit arritën që përmes fotografive, ilustrimeve dhe skicave të marrin më shumë njohuri se sa përmes mësimdhënies klasike, pra rezultatet e këtij studimi mund të merren parasysh për përmirësimin e praktikave të mësimdhënies, këto rezultate në radhë të parë mund të i ndihmojnë mësimdhënësve për organizimin e mësimdhënies dhe pastaj edhe hartuesve të librave shkollorë për përmirësimin e gjendjes aktuale të librave shkollorë sa i përket sasisë së fotografive, ilustrimeve dhe skicave, sepse tek librat e vjeter kryesisht ka më shumë tekst dhe shumë pak pamje.

REFERENCAT BIBLOGRAFIKE

- Aliu, L. (2018). Analizë e sistemit arsimor në Kosovë
- A.Ireland, K. (2010). *Vizualizing human biology*.
- B.Musai. (1999). *Psikologji Edukimi*. Tirane.
- Barab, S. W.-G. (2009). *Academic play spaces*. In R. Fertig (Ed.), *Handbook of research on effective electronic gaming in education* . Hershey, PA: IGI Global.
- Blead, R. (2006). *Finding the true gold*. *EDUCAUSE Review* (Vol. 41(1)).
- C. Roland Christensen, D. A. (2006). *Education for judgment*. Harvard Business School.
- Cook, M. P. (2006). *Visual representations in science education: the influence of prior knowledge and cognitive load theory on instructional design principles*. (Vols. 90(3),). *Science Education*,.
- Damasio, A. L. (2012). *Emozione, Ragione e Cervello Umano*; Adelphi. Milano, Italy.
- Damiano, E. L. (2013). *Per una Teoria Dell'insegnamento*; Franco Angeli:. Milano, Italy,.
- Daud, A. M. (2012). *Creativity in Science Education*. *Procedia-Social and Behavioral Sciences*.
- Edmunds, K. M. (2006). *What teachers can learn about reading motivation through conversations with children*.
- Florax, M. &. (2010). *What contributes to the split-attention effect? The role of text segmentation, picture labelling, and spatial proximity* (Vol. 20(3)). *Learning and instruction*.
- Gilbert, J. (2005). *Visualization in Science Education*. . Dordrecht: Springer. .
- Hannus, M. (2006). *Oppikirjan kuvitus: koriste vai ymmärtämisen apu*. Turun yliopiston julkaisu C 122. .
- Hannus, M. (2006). *The role of pictures in learning biology* (Vol. 24). *Journal of Biological Education*,.

- Kaufman, J. C. (2007). *Captions, consistency, creativity, and the consensual assessment technique: New evidence of reliability. Thinking Skills and Creativity.*
- Kearnsy, J. &. (2009). *How useful are figures in school biology textbooks.* (Vol. 33(2)). Journal of Biological Education.
- Korotkova, M. (2008). *Qasje e orientuar drejt personalitetit në përdorimin e mjeteve vizuale në mësim.*
- Kumar, R. (2014). *Metodologjia e Hulumtimit.*
- Martinec, R. &. (2005). *A system for image-text relations in new (and old) media. Visual Communication.*
- Mayer, R. E. (2009). *Multimedia learning (2nd ed.).* . New York: Cambridge University Press.
- Mayer, R. E. (2003). *The three facets of visual and verbal learners: Cognitive ability, cognitive style, and learning preference.* (Vol. 95(4)). Journal of Educational Psychology.
- Pozzer, L. L.-M. (2003). *Prevalence, function, and structure of photographs in high school biology textbooks.* (Vol. 40(10)). Journal of Research in Science Teaching.
- Pozzer-Ardenghi, L. &.-M. (2005). *Making sense of photographs.* (Vol. 89(2)). Science Education,.
- Rasch, T. &. (2009). *Interactive and non-interactive pictures in multimedia learning environments: effects on learning outcomes and learning efficiency. Learning and Instruction,* (Vol. 19(5)).
- Rautrao, S. (2012). *Significance of Audio-visual Aids In Teaching English Indian Streams.*
- Reid, D. (2010a). *The role of pictures in learning biology: Part 1, perception and observation.* (Vols. 24(3),). Journal of Biological Education.
- Reid, D. (2010b). *The role of pictures in learning biology: Part 2, picture-text processing.* (Vol. 24(4)). Journal of Biological Education,.
- Ritchin, F. (2012). *Dopo la Fotografia; Einaudi,.* Torino, Italy.
- Rivoltella, P. N. (2012). *Insegnare al Cervello che Apprende; Raffaello Cortina.* Milano, Italy.
- Rraci, E. (2021). *Arsimi në Kosovë gjatë pandemisë - Editorial.*

- Schlag, S. &. (2011). *Supporting learning from illustrated texts: conceptualizing and evaluating a learning strategy*. (Vol. 39(6). Instructional Science.
- Sibanda, N. (2009). *Quantitative study*. Retrieved from <http://www.victoria.ac.nz/>.
- Sokolova, A. V. (2006). *Ndihmat vizuale dhe rëndësia e tyre për rritjen e efektivitetit të mësimdhënies së nxënësve me dëmtim shikimi në klasat fillore*.
- Sousa, L., & Richter, B. &. (2017). *The effect of multimedia use on the teaching and learning of Social Sciences at tertiary level: a case study*.
- Swanepoel, S. (2010). *The Assessment of the Quality of Science Education Textbooks: Conceptual Framework and Instruments for Analysis*. . South Africa. : University of South Africa.
- V.Molochkov. (2006). *Dukshmëria si parim mësimor*.

SHTOJCË: PYTËSORI

Ky pytvësor është për nxënësit e klaseve të shtata, dhe ka si qëllim mbledhjen e të dhënave për tezën e masterit “Ndikimi i fotografive ilustrimeve dhe skicave në të nxënit e biologjisë së njeriut”, të gjitha të dhënat e mbledhura do të mbetën konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllime hulumtimi.

1. Si është e ndertuar zemra e njeriut?

2. Përshkruani funksionin e zemrës së njeriut?

3. Përshkruani funksionin e enëve të gjakut?

4. Çfarë nënkuptoni me qarkullim të dyfishtë të gjakut?

5. Çfarë mendoni si shkon gjaku në mushkri?

6. Kur mësoni zakonisht a ju kushtoni më shumë vëmendje fotografive apo tekstit në libër?

7. Cila mendoni se ju ndihmon më shumë gjatë mësimin, fotografitë apo përmbajtja e tekstit?

- 8.** Cilat njohuri i mbani mend më gjatë, ato që merrni përmes fotografive apo ato që mësoni nga përmbajtja e tekstit?

- 9.** A përdorni ndonjëherë fotografi, ilustrim edhe skica gjatë mëimit në orën e biologjisë?

- 10.** A do të deshironit të përdornit më shumë fotografi, ilustrime dhe skica gjatë mësimdhënies së biologjisë?